



### AKTUALE



Dy kryediplomatët e Shqipërisë nga Kosova

### HASAN PRISHTINA DHE GENT CAKAJ

Ismet SYLEJMANI

**FSHATI KEQEKOLLË DIKUR ME 120 SHTËPI, SOT AS ME DHJETË SOSH** F. 6

**QYTETARËT NË GJAKOVË PROTESTUAN KUNDËR VIZITËS SË PELEGRINËVE SERBË** F. 7

**MITROVICA BËHET ME PARKING NËNTOKËSOR** F. 10

### EKONOMI

**'LLAMKOSI' DHE 'GRAND HOTELI', DY SHEMBUJT MË TË KËQIJ TË PRIVATIZIMIT** F. 8

### KULTURË

**KRIKËS LETRARE I BESOJ FARE PAK** F. 8



### SPORT

**KLUBET E SUPERLIGËS DALIN NË 'GJAH'** F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", AIDA DËRGUTI | FAQE 4-5

# PSD-ja dallon nga binomi LDK - LV

Sekretarja e Përgjithshme e Partisë Socialdemokrate (PSD), Aida Dërguti, ka thënë se me veprimet e kësaj partie në Kuvendin e Kosovës, PSD-ja në mënyrë të qartë ka treguar se dallon nga partitë në pushtet dhe ato në opozitë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", deputetja e

PSD-së ka thënë se brenda këtyre gjashtë muajve kjo parti ka krijuar profilin e vet politik në skenën politike të Kosovës. "PSD-ja dallon tashmë qartazi nga partitë që e përbëjnë koalicionin qeverisës, si dhe nga binomi i momentit LDK - LV", ka thënë Dërguti. Ajo ka bërë me dije se

PSD-ja ka mbështetur iniciativë të pozitës dhe të opozitës të cilat kanë qenë në interes kombëtar. Sipas Dërgutit, pa PSD-në nuk do të kishte proces të bashkimit doganor dhe heqje të romingut Kosovë - Shqipëri si dhe riformatizim përmbajtësor të dialogut me Serbinë

## Dialogu thellon 'përplasjet' në mes të LDK-së dhe PDK-së

Dialogu Kosovë - Serbi ka thelluar përplasjen në mes të dy partive më të mëdha në vend, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka kritikuar qasjen e Kadri Veselit në raport me deklaratat që po i bënë për këtë parti rreth mospërfshirjes në dialog. Kritikave të Mustafës u është kundërpërgjigjur zëvendëskryetari i PDK-së, Enver



Hoxhaj, i cili ka thënë se është çasti i fundit për LDK-në që të këndellet nga gjumi i thellë në të cilin ka rënë

## Anketa e Vetëvendosje: Kurti, kandidati më i përshtatshëm për kryeministër

FAQE 9



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



# Rama mbledh qeverinë në Elbasan, diskutohet për sfidat e 2019-s

Kryeministri Rama ka njoftuar se të dielën është diskutuar për sfidat e 2019-s, sektor për sektor dhe në fokus ka qenë rritja e punësimit dhe sipërmarrjes vendëse, përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së shërbimeve publike, masat e reja antikorrupsion

TIRANË, 6 JANAR - Edi Rama dhe Erion Braçe, i pari i qeverisë me dyshin, kanë drejtuar mbledhjen e qeverisë "Rama 3", e cila është zhvilluar në qytetin e Elbasanit. Të pranishëm raportohet se kanë qenë, veç ministrave të kabinetit, edhe ish-ministrat apo ata që pritet të bëhen të tillë, pavarësisht çfarë ndodhi një ditë më parë me dekretimet e presidentit Meta.

Në mbledhje ka marrë pjesë edhe Ditmir Bushati, ministri që nuk dekretohet shkarkimi i tij prej presidentit Meta. Disa burime kanë thënë se në fillim kryeministri nuk ka dashur ta lerë të hyjë në mbledhje ministrin Bushati, duke qenë dyshues se pse presidenti nuk pranon ta shkarkojë me dekret dhe ta emërojë djalosin koso-

var, 28 vjeçin që është diplomuar në Prishtinë dhe ka një specializim të padeklaruar në Budapest në universitetin sorosian. Gjatë gjithë mbledhjes së qeverisë, siç thonë burimet, një ministër që i shpëtoi furisë së largimit, asnjë prej ministrave nuk i fliste Ditmir Bushatit. Të gjithë kishin frikë, sepse Edi Rama e shikonte vëngër dhe mosbesues. Ka mundësi që me rrjedhën e ngjarjeve të pritshme politike këta gjashtë muaj, Ditmir Bushati të shikohet si kandidat për mjaft potenciale për kryeministër nga PS-PD-LSI. Edhe pala gjermane ka shprehur shumë simpati për Bushatin, sikurse edhe "Zëri Amerikës", radio shtetërore e ShBA-së, ka shkruar me rezervë për largimin e tij nga kabi-



neti qeveritar, ndërkohë që e shikojnë emrin e ministrit të propozuar për shef të diplomacisë me mjaft dyshime aftësie.

Një gjë dihet tashmë, se presidenti Meta nuk do ta firmosë asnjëherë shkarkimin e ministrit Bushati, pasi deri tani ka punuar mirë si shef i diplomacisë shqiptare dhe ka treguar integritet me homologët evropianë e sido-

mos me ata amerikanë. Ndërkohë burimet thonë se nëse presidenti përfundimisht nuk e firmos dekretin e shkarkimit për Ditmir Bushatin, atëherë kryeministri ka mundësi ta marrë vetë rolin edhe si ministër i Jashtëm, por mundet edhe ta propozojë emrin e Jozefina Topallit si ministre të Jashtëm.

Jozefina Topalli mbetet një figurë karizmatike dhe me shumë

njohje e lidhje ndërkombëtare, ndonëse ky do të ishte edhe një diversion i hapur ndaj kryetarit të PD-së, Lulzim Basha, si dhe test për Sali Berishën dhe shikohet edhe si një hap që po luhet në skutat e errëta politike për një qeveri të përbashkët PD-PS. "Ditë diskutimi për sfidat e 2019-s, sektor për sektor. Në fokus, rritja e punësimit dhe sipërmarrjes vendëse; përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së shërbimeve publike; masat e reja antikorrupsion dhe rekrutimi në administratë i të rinjve me 9-10", shkroi kryeministri Rama vetëm pak pasi kishte nisur mbledhja, në rrjetin social.

Ndërkohë, mbledhja e Qeverisë është pritur me protesta nga një grup i vogël qytetarësh. Mes tyre është vënë re edhe prania e kreut të Degës së PD-së në Elbasan, Eugen Isaj. Me thirrjet "Rama, ik!" dhe "Qeveri e krimi!", banorëve iu është bashkuar edhe deputeti i PD-së, Luçiano Boçi. Gjithashtu, qytetarët kanë përdorur edhe tymuese gjatë protestës që zgjati disa minuta.

## Bushati ishte kundër ndryshimit të kufijve të Kosovës

TIRANË, 6 JANAR - Në një intervistë radiofonike, që ka shkaktuar komente dhe reagime të shumta, ish-ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, iu referohet edhe marrëdhënieve me Shqipërinë. Ai kritikon në fillim opozitën, "Demokracinë e Re" dhe tonet që përdor në lidhje me Ankaranë e Tiranën, duke theksuar se politika e jashtëm greke nuk duhet t'i ketë të njëjtat tone, ose të konkurrojë performancat e diplomacisë turke dhe shqiptare.

Kotzias i ka quajtur të papranueshme deklaratat e kreut të opozitës greke, Kyriakos Mitsotakis, se me veprimet e saj



Shqipëria nuk do të mund të bëhet pjesë e BE-së. "Këto çështje kryhen vetëm me veprime diplomatike serioze

dhe do t'ia kujtoja 'Demokracisë së Re' se e bëri Shqipërinë pjesë të NATO-s pa asnjë kusht", ka deklaruar Kotzias.

Gjithashtu, ish-kreu i diplomacisë greke ka komentuar edhe ndryshimet e kabinetit qeveritar në Shqipëri, veçanërisht ndryshimin e ministrit të Jashtëm. "Në këtë historinë e toneve të larta, më racional, më luftëtari për pikëpamjet e tij, i ri në moshë, por një njeri shumë i pjekur, ministri i Jashtëm më serioz që kishte Shqipëria për të negociuar, Bushati u largua nga detyra. U largua, për mendimin tim, jo sepse kishte shumë vite ministër, siç thuhet në Shqipëri, por sepse kishte një pikëpamje të ndryshme për çështjen e Kosovës, domethënë nuk pajtohej me ndryshimin e kufijve", ka

thënë ai. "Dhe, e dyta, ka sqaruar Kotzias, sepse kishim bërë këtë përpjekje për një paketë marrëveshjeje, e cila kishte përfunduar, por kishte dy probleme. Njëri nga pala shqiptare, pasi nuk ekzistonte Gjykata Kushtetuese që t'i certifikonte ndryshimet në një sërë çështjesh, sepse kishte vetëm dy nga 11 gjykatësit në këtë moment; dhe i dyti, sepse sa i përket Shqipërisë, ka edhe në shtetin grek një segment fundamentalist për të cilin nuk kam vendosur ende që të flas, por e kam informuar me detaje kryeministrin para se të largohem", ka thënë Kotzias.

## Kryemadhi kërkon rrëzimin e Ramës

TIRANË, 6 JANAR - Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, u ka bërë thirrje studentëve të Elbasanit që t'i bashkohen protestës së studentëve, duke shtuar se ajo nuk duhet të ndalojë deri në plotësimin e tetë kërkesave. Sipas saj, Rama është një dreq që nuk duhet mbajtur brenda sepse dreqi brenda është mallkim për shqiptarët. "Protesta e studentëve nuk do të ndalojë

deri në plotësimin e tetë kërkesave. Studentët nuk protestojnë vetëm për vete, por edhe për familjarët që sakrifikojnë për shkollimin e tyre. Dua që t'ua shtrini dorën të gjithë të rinjve për të marrë pjesë në protestën e nesërme. Nuk ka të bëjë me thirrjen e LSI-së, por të një gruaje që lufton për fëmijët e vet. Çdo shqiptar do ta bënte këtë për fëmijët e vet. Nuk mund të mba-

jmë dreqin brenda, pasi dreqi brenda është mallkim për shqiptarët. Më mirë pa kryeministër se me Ramën kryeministër. Të bashkohemi për të përmbysur këtë të keqe të madhe. E keqja e madhe nuk është PS-ja, por Edi Rama. Se Edi Rama pasi të mbarojë vetingun me pedagogët, do të fillojë me mësuesit e shkollave të mesme e pastaj më tej. Pse nuk e fillon vetingun me

veten e tij?! Shiheni si tha, njëherë i kam paratë e shtëpisë me emigracion, dje tha se ma ka blerë gruaja. Një mashtrues", u shpreh Kryemadhi.

Ndërkohë, ajo tha se në partinë e Ramës nuk ka më socialistë dhe se aty kanë mbetur vetëm dy persona që nuk kanë në dorë asgjë. "Ma gjeni një socialist në Qeveri. Dy janë: Erion Braçe dhe Pandeli Majko, njerëz që nuk



kanë asgjë në dorë. Njerëzit që vuajnë sot më shumë dhe janë më të diskriminuarit janë socialistët, prandaj ne duhet t'i hapim dyert e partisë", tha Kryemadhi.



# Dialogu thellon 'përplasjet' në mes të LDK-së dhe PDK-së



Dialogu Kosovë - Serbi ka thelluar përplasjen në mes të dy partive më të mëdha në vend, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka kritikuar qasjen e Kadri Veselit në raport me deklaratat që po i bënë për këtë parti rreth mospërfshirjes në dialog. Kritikave të Mustafës u është kundërpërgjigjur zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, i cili ka thënë se është çasti i fundit për LDK-në që të këndellet nga gjumi i thellë në të cilin ka rënë

Kadriun. Por, fati politik është tjetër. As Serbia nuk do të përballojë pa hyrë në dialog dhe pa e njohur Kosovën, e as Kadriu s'ka forcë ta shtyjë këtë proces duke e ofenduar LDK-në dhe opozitën që përfaqësojnë shumicën në Kuvend", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas tij, nuk është përgjegjësi e LDK-së pse koalicioni qeverisës është i dobët, pse s'ka fuqi ta përballojë dialogun dhe pse kryeministri i ikën përgjegjësisë së tij në dialog. "Nuk është, po ashtu, përgjegjësi e LDK-së që dikush harron se Kosova e ka shpallur pavarësinë, se kemi institucione kushtetuese dhe se asnjë grup i derivuar nuk duhet dhe nuk mund t'i zëvendësojë këto institucione", ka theksuar Mustafa. Ai ka thënë se për LDK-në nuk ka ekip të unitetit me njerëz jounifikues, me njerëz që ofendojnë, gënjejnë e shpifin. Dhe, sipas Mustafës, Kosovës nuk i nevojitet kurrfarë ekipi i unitetit në kohën kur i ka të gjitha institucionet kushtetuese. "Nëse këto institucione janë të paafta ta kryejnë punën e tyre, duhet të

themelohen institucione të tjera përfaqësuese e jo ekipe që u shërbejnë institucioneve pa legjitimitet", është shprehur Mustafa, duke shtuar se LDK-ja ka qenë pjesë e të gjitha proceseve shtetformuese por, sipas tij, dialogu me Serbinë nuk është shtetformues. "Shtetin e kemi formuar dhe e kemi shpallur në këta kufij më 17 shkurt 2008. Dialogu është për të na njohur Serbia, jo për ta mbyllur çështjen e shtetësisë, sepse kjo çështje është e mbyllur dhe askush nuk ka të drejtë ta hapë", ka deklaruar Mustafa.

shirjes në dialogun me Serbinë. Hoxhaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se asnjëherë nuk është vonë për LDK-në që ta japë kontributin e saj për ta përmbyllur shtetndërtimin e Kosovës. Madje ai ka thënë se është momenti i fundit për LDK-në që të këndellet nga gjumi i thellë në të cilin ka rënë. "Asnjëherë nuk është vonë për LDK-në ta japë kontributin e saj për ta përmbyllur shtetndërtimin e Kosovës. Është momenti i fundit për LDK-në që të këndellet nga gjumi i thellë në të cilin ka rënë dhe të mos i përsërisë gabimet e së kaluarës, duke qenë në bisht të proceseve politike dhe historike. Dua të besoj se brenda kësaj partie ka vullnet, dije dhe guxim për të vepruar në interes të vendit, duke u bërë bashkë që të merremi me Serbinë dhe jo me njëri-tjetrin. Por, duket se problemi është diku tjetër: nuk ka një mendim të prerë dhe të vendosur për asgjë. Mbi të gjitha, kjo parti herë synon të thirret në trashëgiminë rugoviane e herë të sillet si ekstreme duke i ngjarë VV-së", ka shkruar Enver Hoxhaj.

**EPOKA  
ERE** Shqipëri **HETEMI**

PRISHTINË, 6 JANAR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka kritikuar të dielën drejtuesit e koalicionit qeverisës për qasjen ndaj procesit të dialogut me Serbinë. Në kohën kur Kosovës i nevojiten përpjekje për ta gjetur rrugën më të mirë për ta përballuar dialogun me Serbinë, ai ka thënë se ka filluar një fushatë e ndyrë e udhëhequr nga Kadri Veseli dhe lakenjtë e tij kundër LDK-së. Sipas Mustafës, kjo nuk është e

mirë sepse nuk mund të kryejnë punë duke e provokuar LDK-në. "Kadriu (Kadri Veseli) si kryetar i Kuvendit dhe kryetar i PDK-së, dhe lakenjtë e tij s'lënë gjë të keqe pa ia atribuuar LDK-së, e njollosin me lloj-lloj etiketimesh, e në anën tjetër kërkojnë që LDK-ja të bashkëpunojë me ta dhe me koalicionin e tyre në dialog. As nuk ka dëshirë Serbia që ta përparojë dialogun dhe ta njohë Kosovën, e as Kadriu që të bashkëpunojë me LDK-në, sepse këtë e ka vërtetuar. Në këto rrethana, aq më pak ka vullnet LDK-ja të punojë bashkë me

## Hoxhaj, Mustafës: Është momenti i fundit për LDK-në të këndellet nga gjumi

Ndërkohë zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, i cili është edhe zëvendëskryeministër, u është kundërpërgjigjur akuzave të liderit të LDK-së, Isa Mustafa, i cili e ka kritikuar qasjen e Kadri Veselit në raport me deklaratat që po i bënë për këtë parti rreth mospërf-

## Kurti thotë se ideja për shkëmbim territoresh vjen nga Serbia dhe Rusia

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se ideja për shkëmbim territoresh është projekt që vjen nga Serbia dhe Rusia. Ai ka cituar një letër të ish-kryenegociatores Edita Tahiri, dërguar përfaqësueses të lartë të BE-së, Federica Mogherinit, ku theksohet se ideja për ndryshim të kufijve në rajonin e Ballkanit është skenar i ndikuar nga Rusia. "Znj. Tahiri e patëm kundërshtuar e kritikuar me të drejtë përgjatë dialogut 2011-2017 me Serbinë. Mund të jetë vetëm më keq sesa që e thotë ajo

në këtë letër që sot i mbushi një vit e gjysmë. Aventura personale e presidentit të Kosovës gjithsesi nuk është edhe projekt personal. Ky projekt vjen nga Serbia e Rusia, pra nga verilindja, në kontrast me aleancën e veriperëndimit, NATO-n. Në letrën e saj dërguar znj. Mogherini, që mban datën 6 korrik 2017, ish-ministrja pa Portofol dhe ish-kryenegociatorja e Kosovës, znj. Edita Tahiri, ndër të tjera, shkruan edhe këtë: 'Serbia, gjithashtu, u përpoq të luante disa skenarë të natyrës gjeopolitike, duke promovuar

idetë e ndryshimit të kufijve në rajon dhe këmbimin e territoreve, të cilat dukej se ishin ndikuar nga Rusia dhe ambiciet e saj për ta rikthyer ndikimin e saj, të humbur pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Këta janë skenarë mjaft të rrezikshëm, të cilët kundërshtohen nga Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, duke qenë se pozicioni ynë i përbashkët strategjik është rreshtimi me botën perëndimore dhe me komunitetin euroatlantik", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".





Flet për "Epokën e re", Aida Dërguti

# PSD-ja dallon nga

Sekretarja e Përgjithshme e Partisë Socialdemokrate (PSD), Aida Dërguti, ka thënë se me veprimet e kësaj partie në Kuvendin e Kosovës, PSD-ja në mënyrë të qartë ka treguar se dallon nga partitë në pushtet dhe ato në opozitë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", deputetja e PSD-së ka thënë se brenda këtyre gjashtë muajve kjo parti ka krijuar profilin e saj politik në skenën politike të Kosovës. "PSD-ja dallon tashmë qartazi nga partitë që e përbëjnë koalicionin qeverisës, si dhe nga binomi i momentit LDK - LV", ka thënë Dërguti. Ajo ka bërë me dije se PSD-ja ka mbështetur iniciativa të pozitës dhe të opozitës të cilat kanë qenë në interes kombëtar. Sipas Dërgutit, pa PSD-në nuk do të kishte proces të bashkimit doganor dhe heqje të romingut Kosovë - Shqipëri si dhe riformatizim përmbajtjesor të dialogut me Serbinë



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 6 JANAR** - Sekretarja e Përgjithshme e Partisë Socialdemokrate (PSD), Aida Dërguti, ka treguar se kjo parti brenda këtyre gjashtë muajve ka krijuar profilin politik në skenën politike të Kosovës. Ajo ka thënë se PSD-ja dallon tashmë qartazi nga partitë që e përbëjnë koalicionin qeverisës dhe ato të opozitës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Dërguti, e cila është edhe nënkryetare e Kuvendit të Kosovës, ka thënë se për këto arsye ky subjekt politik është venë në thumb të kritikave nga dy subjektet e

tjera opozitare. "Përpjekja dhe zhurma e dy partive të tjera opozitare për ta krijuar përshtypjen se jemi të afërt me pushtetin ka vetëm një motiv: të ndërtojnë konstruksione fiktive të zgjedhësit, sepse tashmë është e qartë se Partia Socialdemokrate ka krijuar profilin e saj politik në skenën politike të Kosovës. PSD-ja dallon tashmë qartazi nga partitë që e përbëjnë koalicionin qeverisës, si dhe nga binomi i

momentit LDK - LV", ka thënë Dërguti. Ajo ka përmendur disa prej veprimeve të pushtetit të cilin nuk do të ishin ndërmarrë pa presionin e kësaj partie. Sipas Dërgutit, përqendrimi në ushtrimin e politikave zhvillimore e barazitare, si dhe jetësimi i tyre e ka vënë në siklet mazhorancën dhe dy partitë e tjera opozitare. "Ne kemi shfrytëzuar mundësitë dhe rrethanat e sotme për ta detyruar mazhorancën që t'i

mbështesë politikat tona që janë në interes të Republikës, duke i kundërshtuar ato që janë në kundërshtim me interesin e përgjithshëm. Pa Partinë Socialdemokrate nuk besoj se sot do t'i kishim sot në proces bashkimin doganor dhe heqjen e romingut Kosovë - Shqipëri, riformatizimin përmbajtjesor të dialogut me Serbinë, rritjen e pagave në sektorin publik (sidomos të shëndetësisë), reformën në sektorin e bujqë-

sisë dhe atë pensional etj", është shprehur ajo, duke shtuar se PSD-ja ka mbështetur edhe shumicën e iniciativave nga dy partitë e tjera opozitare, pavarësisht prej akuzave të këtyre partive ndaj PSD-së. Pretendimet e LDK-së dhe të LV-së se kjo parti do të bëhet pjesë e Qeverisë ajo i ka quajtur absurde dhe qesharake. Sipas Dërgutit, për vetëm gjashtë muaj prej se ekzistojnë si grup parlamentar, PSD-ja ka iniciuar

# binomi LDK - LV



pesë rezoluta nga të cilat më shumë se gjysma janë në prag të jetësimit, dy interpelanca: gjashtë debate parlamentare, 21 deklarata jashtë rendit të ditës, dy projektligje dhe 40 pyetje parlamentare.

**"Epoka e re":** Znj. Dërguti, PSD-ja gjatë vitit të kaluar vazhdimisht është kritikuar nga dy subjektet e tjera opozitare për mbështetje të pushtetit. Kjo kritikë u shtua pasi ky subjekt

politik u bë pjesë e ekipit negociator të Kosovës dhe pasi votoi projektbuxhetin e Qeverisë. Cili është komenti juaj për këto kritika?

**Dërguti:** Kritika e dy subjekteve opozitare ishte e pritshme. Një grup i ri parlamentar si PSD-ja, që dëshmon çdo ditë e më shumë kapacitete intelektuale, politike dhe profesionale, shkakton natyrshëm shqetësim dhe panik në mesin e subjekteve të tjera politike. Përpiqja

dhe zhurma e dy partive të tjera opozitare për ta krijuar përshypjen se jemi të afërt me pushtetin ka vetëm një motiv: të ndërtojnë konstruksione fiktime te zgjedhësit sepse tashmë është e qartë se Partia Socialdemokrate ka krijuar profilin e saj politik në skenën politike të Kosovës. PSD-ja dallon tashmë qartazi nga partitë që e përbëjnë koalicionin qeverisës si dhe nga binomi i momentit LDK - LV.

**"Epoka e re":** Çfarë e ka dalluar PSD-në në aktivitetin e saj opozitar nga dy partitë e tjera, LDK-në dhe LV-në?

**Dërguti:** Përqendrimi në ushtrimin e politikave zhvillimore e barazitare, si dhe në jetësimin e tyre me rezultate konkrete. Kjo e ka vënë në siklet edhe mazhorancën, edhe dy partitë e tjera opozitare. Ne kemi shfrytëzuar mundësitë dhe rrethanat e sotme për ta detyruar mazhorancën që t'i mbështesë politikën tona që janë në interes të Republikës, duke i kundërshtuar ato që janë në kundërshtim me interesin e përgjithshëm. Pa Partinë Socialdemokrate nuk besoj se sot do t'i kishim sot në proces bashkimin doganor dhe heqjen e romingut Kosovë - Shqipëri, riformatizimin përmbajtësor të dialogut me Serbinë, rritjen e pagave në sektorin publik (sidomos të shëndetësisë), reformën në sektorin e bujqësisë dhe atë pensional etj. PSD-ja ka mbështetur edhe shumicën e iniciativave nga dy partitë e tjera opozitare, pavarësisht prej akuzave, shpifjeve dhe shpërfilljes së tyre ndaj nesh. Kjo dëshmon se nuk veprojmë me inate fëmijërore dhe që jemi një subjekt i pjekur politik, pa harruar aktivitetin intensiv brenda Kuvendit me iniciativat e ndërmarra. Për vetëm gjashtë muaj prej se ekzistojmë si grup parlamentar, PSD-ja ka iniciuar pesë rezoluta nga të cilat më shumë se gjysma janë në prag të jetësimit, dy interpelanca, gjashtë debate parlamentare, 21 deklarata jashtë rendit të ditës, dy projektligje dhe 40 pyetje parlamentare. Është e paparë në historinë e re të punës së grupeve parlamentare në Kuvendin e Republikës.

**"Epoka e re":** Cili do të jetë raporti i PSD-së me Qeverinë gjatë vitit 2019? Kundërshtarët tuaj politikë kanë paralajmëruar se mund të bëheni pjesë e Qeverisë.

**Dërguti:** Aq sa është absurde, po aq është edhe qesharake që kundërshtarët tanë të flasin për përfshirjen tonë në Qeveri. Sepse këtë nuk mund të na e tregojnë ata sikurse asnjë veprim tjetër. Më mirë sesa të merren me veprimet tona do të ishte që kundërshtarët tanë të merren me veten, të tentojnë të gjejnë qëndrime të përafërta mbi proceset dhe zhvillimet brenda partive të tyre. Ne do të vazhdojmë ashtu siç kemi vepruar deri tani, duke i kundërshtuar, kri-

tikuar dhe penguar veprimet e dëmshme dhe duke i mbështetur e shtyrë përpara ligjet e vendimet që janë në favor të qytetarëve. Njësoj, s'do t'i përfillim aspak akuzat e ulëta e kritikën dashakeqe që na bëhen nga tabori opozitar.

**"Epoka e re":** Sidomos në pjesën e dytë të këtij viti, ky subjekt politik ka hapur disa degë nëpër Kosovë. Sa jeni konsoliduar në terren gjatë këtij viti?

**Dërguti:** Hapjen e degëve e kemi filluar kah mesi i shtatorit. Deri më tani kemi hapur 15 degë gjithandej nëpër Kosovë. Do të vazhdojmë edhe gjatë vitit të ardhshëm me hapjen e degëve të reja dhe kjo fazë do të përmbyllet më së largu deri në mars. E konsideroj si proces mjaft të suksesshëm deri tani, marrë parasysh se puna në terren kërkon dhe merr shumë energji. Por, ne, përkundër aktivitetit të shtuar në Kuvend, ia kemi dalë të shtrihemi dhe fuqizohemi gjithandej vendit. Vërejmë se ka shumë interesim qytetar që të bashkohen krahet nesh dhe ky është sinjal që në një të ardhme të afërt do ta kemi një organizatë shumë të fuqishme.

**"Epoka e re":** Cili është vlerësimi i PSD-së për punën e deritashme të Qeverisë Haradinaj?

**Dërguti:** Ne nuk kemi pasur kurrfarë pritjesh nga kjo Qeveri, prandaj edhe nuk e kemi votuar. Në keqqeverisje nuk dallon nga qeveritë e tjera të pasluftës. Mirëpo, mungesa e numrave në Kuvend e detyron këtë Qeveri të jetë më bashkëpunuese me opozitën, për dallim të qeverive që kanë pasur 2/3 në Kuvend dhe kanë qeverisur me arrogancë.

**"Epoka e re":** Çfarë ka bërë mirë e çfarë keq kjo Qeveri, sipas PSD-së?

**Dërguti:** Kjo Qeveri shquhet për nga numri i skandaleve, tashmë të njohura për publikun. Përveç tyre, ka ngecje në shumë procese integruese të vendit, por për çfarë e ndan fajin me qeveritë paraprake, që të jemi deri në fund korrekt. Mirëpo, kjo Qeveri do të mbahet mend edhe për dy vendime të rëndësishme që i ka marrë. E kam fjalën për bërjen e ushtrisë, për çfarë, fatmirësisht, kishte unitet brenda gjithë spektrit politik. Dhe, së dyti, për taksën ndaj Serbisë, që në rrethanat aktuale ishte kundërpërgjigja më e mirë ndaj agresionit diplomatik të këtij shteti ndaj Kosovës.



# Fshati Keqekollë dikur me 120 shtëpi, sot as me dhjetë sosh



Përkundër të gjitha të mirave që ka fshati Keqekollë, sot është buzë mbetjes pa asnjë banor. Ky fshat është duke u boshatisur në heshtje. Dikur i kishte 120 shtëpi, sot mezi i ka 10 sosh të banueshme. Përkundër të gjitha begative natyrore që i ka ky fshat i Gollakut, i cili kufizohet me fshatrat malore, Koliq, Ballaban dhe Prapashticë, nuk po adhurohet nga ish-banorët e tij dhe nga ata pak që janë ende në Keqekollë, i cili është 29 kilometra larg Prishtinës

**EPOKA  
ERE** Ismail REXHEPI

**PRISHTINË, 6 JANAR** - Fshati Keqekollë i Komunës së Prishtinës është një vend me bukuri të rrallë natyrore. Ka pyje në sipërfaqe qindra hektarësh, lumë, burime të ujit, tokë të punueshme, livadhe të shumta, pemë thuajse të të gjitha llojeve që i ka dhuruar natyra këtij fshati, rrugë të asfaltuar, shkollë... Mirëpo, përkundër të gjitha këtyre të mirave që i ka Keqekolla, ai është buzë mbetjes pa asnjë banor. Ky fshat është duke u boshatisur në heshtje. Dikur i kishte 120 shtëpi, sot vështirë mezi i gjen 10 të

banueshme. Përkundër të gjitha begative natyrore që i ka ky fshat i Gollakut, i cili kufizohet me fshatrat malore, Koliq, Ballaban dhe Prapashticë, nuk po adhurohet nga ish-banorët e tij dhe nga ata pak që janë ende në Keqekollë, i cili është 29 kilometra larg Prishtinës.

Nga biseda që bëmë me disa nga banorët e këtushëm, mesojmë se shkak i ikjes së tyre nga Keqekolla është i lidhur për mungesë transporti të rregullt të banorëve me Prishtinën, udhëtimi i lartë dhe me vështirësi gjatë dimrit si për punëtorë ashtu edhe për nxënës e studentë. Mirëpo, mbi të gjitha, është punësimi i

keqekollasve në Prishtinë. Pra, si thonë ata, assesi nuk ia vlen të bëhen afër 60 kilometra rrugë për të shkuar në punë dhe për t'u kthyer vetëm për të fjetur në këtë fshat. Pra, e gjithë paga shkon shpenzime të rrugës.

Faik Rama ende jeton në Keqekollë dhe merret me blegtori, bletari e perimtari, si dhe është edhe kultivues i mirë i drithërave dhe ushqimit për bagëti, ka pohuar se edhe ai vetë një ditë do të largohet nga fshati. "Në këtë lagjen tonë kur dikur kishte me shumë shtëpi, sot jetojmë vetëm dy familje. Pra, unë dhe një i afërm i imi. Jeta me vetëm këto dy shtëpi nuk është e lehtë, nuk ndihet kurrfarë gjallërie, s'ka zhurmë të njerëzve siç ishte përpara. Unë jetoj me bashkëshorten dhe dy fëmijët e mi, si dhe pak anëtarë të afërmit tim, po më duket po na ha mali. Keqekolla është një vend i mrekullueshëm për të ushtruar shumë veprimtari në bujqësi dhe ekonomi. Këtu mund të merresh me blegtori, sepse ka sipërfaqe të shumta të kullosave, pastaj me blegtori, bletari... Unë kam disa

lopë qumështore, disa bletë, e punoj tokën, si dhe gjatë vjeshtës shesim dru që i kemi në pronësi tonën disa hektarë me mal. Gjithashtu, bëj bartjen me furgon të pak fëmijëve që janë në lagjen tonë deri në shkollën e fshatit, që është bukur larg ku jetojmë ne. Pra, i çoj në shkollë dhe kur të përfundojë mësimi i kthej në shtëpi. Mirëpo, përkundër këtyre punëve që i bëj, edhe unë do ta lëshoj fshatin kur fëmijët nisin mësimin në shkollë të mesme në Prishtinë. Madje, ka muaj që e kam blerë një truall afër Prishtinës ku mendoj të ndërtoj një shtëpi. Dua të them se në këtë fshat kanë mbetur pak shtëpi që numërohen në gishta. I gjithë fshati iku në Prishtinë për shkak të kushteve më të mira për jetë, në rend të parë për punësim. Pra, s'ka banor që ka shkuar në qytet e nuk është punësuar diku", ka thënë ai.

Rama ka thënë se sikur të gjithë të rrinin në fshat jeta do të bëhej e rëndë si pasojë e papunësisë. "Të gjithë nuk kanë mundur të merren me blegtori,

sepse edhe nga kjo punë pak fitohet", është shprehur ky banor i Keqekollës.

Thuajse ngjashëm u shpreh edhe një banor tjetër. Ai ka paralajmëruar se së shpejti do ta lëshojë fshatin me familje. "Djali im punon në Fushë-Kosovë dhe nuk po ia vlen të udhëtojë. Krejt rroga po i shkon për udhë. E kemi blerë një banesë në këtë qytet dhe do të jetojmë atje. Në këto hapësira kemi mbetur vetëm ne dy familjet, pra unë dhe Faiku", ka thënë Ahmet Rama. Ai ka shtuar se ka pak perspektivë për banorët e këtij vendi. "Blegtorja, bujqësia e bletaria nuk është zgjidhje për të jetuar këtu. Bazuar në numrin e banorëve që ende janë duke jetuar në Keqekollë, një ditë të afërm do të mbetet i tëri i boshatisur", ka thënë Ahmet Rama.

ShFMU "Rilindja", edhe pse shkollë e re dhe me infrastrukturë moderne, ka një numër të vogël të nxënësve. Problem janë edhe rrugët e paasfaltuara në mes të lagjeve të fshatit Keqekollë të Komunës së Prishtinës.

## Liderët urojnë besimtarët ortodoksë

**PRISHTINË, 6 JANAR (ER)** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj kanë uruar besimtarët ortodoksë me rastin e Krishtlindjes. "Të gjithë besimtarëve ortodoksë u shpreh urimet më të mira në ditën e

Krishtlindjes së tyre. Le të ketë edhe më shumë paqe, lumturi dhe begati në familjet e tyre. Gëzuar kjo ditë e shenjtë!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se realiteti shumëfetar i shoqërisë sonë

duhet të na shërbejë si motiv shtesë që ta ndërtojmë një shtet, që garanton më shumë shpresë, mirëqenie ekonomike dhe siguri për qytetarët. Kurse zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se kjo ditë duhet të shërbejë për më shumë tolerancë dhe respekt për njëri-tjetrin.





# Qytetarët në Gjakovë protestuan kundër vizitës së pelegrinëve serbë

Në dyert e kishës ortodokse serbe në Gjakovë qytetarët protestues vendosën të dielën pankarta me mbishkrime të ndryshme "Gjakova nuk harron" dhe "I keni duart me gjak". Kjo protestë u organizua kundër vizitës së pelegrinëve serbë për festën e Krishtlindjeve Ortodokse, por këtë herë, sipas institucioneve të vendit, nuk ka pasur asnjë kërkesë nga asnjë grup pelegrinësh për t'i vizituar objektet fetare në Gjakovë



nuk ka pasur informacione se do të vijnë. Ata nuk kanë bërë asnjë kërkesë tek organet relevante që

duhet t'i japin leje për një vizitë të tillë", ka thënë Hasi.

Këtë gjë e ka bërë me dije edhe këshilltari politik i ministrit të Jashtëm, Jetlir Zyberaj. "Republika e Kosovës respekton dhe garanton të drejtën e secilit qytetar për t'i praktikuar ritet fetare. Megjithatë, sa për ta informuar opinionin publik, sot nuk do të ketë kurrfarë pelegrinazhi në asnjë qytet të Kosovës, sepse një gjë e tillë nuk është kërkuar nga institucionet e Kosovës. Nuk ka asnjë kërkesë zyrtare për këtë dhe rrjedhimisht nuk ka asgjë të planifikuar. Bashkëndejmë me shqetësimet e nënave dhe qytetarëve të Gjakovës, por i garantojmë të gjithë që asnjë kriminel nuk do të jetë asnjëherë pjesë e grupit të

pelegrinëve serbë sepse vendi i tyre do të jetë në burg. Të gjithë kriminelët serbë që kanë kryer krimet më ç'njerëzore që nga Lufta e Dytë Botërore duhet të dalin para drejtësisë", ka shkruar Zyberaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, e cila ishte e pranishme në këtë protestë, ka thënë se kriminelët nuk kanë vend këtu. "Kisha që ishte vendi ku bekoheshin kriminelët para se të kryenin masakrat në familjet gjakovare nuk është vend i pelegrinazhit. Edhe sivjet qytetarët bënë punën që do të duhej ta bënin institucionet tona. Kriminelët nuk kanë vend këtu", ka thënë Nagavci.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**GJAKOVË, 6 JANAR** - Qytetarët në Gjakovë kanë protestuar të dielën duke kundërshtuar, siç janë shprehur ata, një vizitë të pelegrinëve serbë. Në dyert e kishës ortodokse serbe në Gjakovë qytetarët protestues vendosën pankarta me mbishkrime të ndryshme "Gjakova nuk harron" dhe "I keni duart me gjak". Në një njoftim për media, organizatorët e protestës kanë thënë se ata do ta kundërshtojnë ardhjen e pelegrinëve pasi, sipas tyre, në mesin e tyre ka edhe persona që kanë kryer krime gjatë luftës së fundit

në Kosovë.

Protestuesit, pasi qëndruan para kishës ortodokse, u shpërndanë të qetë. Sipas Policisë, e cila doli për ta ruajtur sigurinë, protesta ka qenë e qetë dhe ka kaluar pa incidente. Sipas protestuesve, një grup i pelegrinëve serbë pritej që të dielën ta vizitonin Gjakovën për festën e Krishtlindjeve Ortodokse. Por, drejtori i Policisë Rajonale të Gjakovës, Ahmet Hasi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se nuk ka pasur asnjë kërkesë nga asnjë grup pelegrinësh se sot do t'i vizitojnë objektet fetare në Gjakovë. "Pelegrinë nuk ka, vizitorë nuk ka prej askund. Ata (pelegrinët) kanë ardhur për çdo vit, por kësaj here



## Anketa e Vetëvendosjes: Kurti, kandidati më i përshtatshëm për kryeministër

Lëvizja Vetëvendosje në një konferencë për media ka bërë publike të gjeturat e anketës së radhës të kësaj partie të bërë në muajin dhjetor nga UBO Consulting. Sipas kësaj ankete, lideri i LV-së, Albin Kurti, është kandidati më i preferuar i qytetarëve për kryeministër

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 6 JANAR** - Nënkrjetari i Lëvizjes Vetëvendosje!, Besnik Bislimi, ka prezantuar të dielën në një konferencë për media rezultatet e anketës së realizuar në periudhën 11 - 18 dhjetor 2018 nga UBO Consulting. Sipas kësaj ankete, nëse zgjedhjet parlamentare do të mbaheshin tani, Lëvizja Vetëvendosje do të merret 22.6 për qind të votave, kurse Lidhja Demokratike e Kosovës

(LDK) 27.1 për qind. Sipas kësaj ankete, po të përkthehej në ulëse në parlament, i bie që LV-ja dhe LDK-ja do të merrnin bashkë 56 ulëse në raport me 44 për subjektet e tjera politike.

Sipas anketës, kandidati më i përshtatshëm për kryeministër është Albin Kurti, ku 19.7 për qind e të anketuarve preferojnë atë për kryeministër, i cili pasohet nga Kadri Veseli me 15.8 për qind, Ramush Haradinaj me 14.9 për qind dhe Isa Mustafa me 13.2 për qind. "Që nga muaji

mars që i kemi bërë anketat prin lideri i partisë sonë, Albin Kurti në vazhdimësi me 19.7 për qind, i cili pasohet nga Kadri Veseli me 15.8 për qind, Ramush Haradinaj me 14.9 për qind, Isa Mustafa me 13.2 për qind. Shpend Ahmeti, Fatmir Limaj, Mimoza Kusari dhe Behgjet Pacolli radhiten të fundit me 4.4 për qind, 4.3 për qind, 2.3 për qind dhe 1.4 për qind", ka treguar nënkryetari i kësaj partie, Besnik Bislimi gjatë prezantimit të rezultateve.



Më tutje, nënkryetari i LV-së, Besnik Bislimi, ka thënë se në bazë të kësaj shihet se liderët politikë që janë pjesë e ekipit negociator nuk mund ta për-

faqësojnë Kosovën në dialog me Serbinë. Bislimi ka thënë se Vetëvendosja ka rritje të vazhdueshme gjatë vitit 2018, ndërsa PDK-ja po vazhdon me rënie.



# 'Llamkosi' dhe 'Grand Hoteli', dy shembujt më të këqij të privatizimit



PRISHTINË, 6 JANAR - Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë i filluar si proces në vitin 2003 nuk ka rezultuar me ringjallje dhe zhvillim biznesi për shumë prej tyre. Dy nga shembujt më të 'këqij' të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë konsiderohet të jenë ndërmarrja e llamarinës "Llamkos" dhe "Grand Hoteli". Të dy nga këto ndërmarrje të cilat u privatizuan në valët e para të procesit të privatizimit nuk kanë arritur të tregohen të suksesshme në afarizmin e tyre. "Llamkosi" dhe "Grand Hoteli" u privatizuan me metodën e "spin-off-it special" që nënkupton se blerësi nuk ka të drejtë t'ua ndërrojë destinimin, gjithashtu duhet të punësojë një numër të caktuar të punëtorëve dhe të realizojë investime të reja.

Valon Tolaj, drejtor menaxhues

në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se "Llamkosi" është në procedurë të falimentimit dhe se AKP-ja nuk ka kompetencë ligjore mbi "Llamkosin", derisa "Grand Hoteli" është në procedurë të likuidimit. "Të dyja këto ndërmarrje kanë qenë të privatizuara nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit dhe AKP si trashëgimtare ka pasur për obligim që ta mbikëqyrë zbatimin e kontratave të privatizimit dhe për shkak të moszbatimit të kushteve të kontratës, AKP ka qenë e detyruara ta bëjë tërheqjen e aksioneve. Si pasojë e kësaj, të dy ndërmarrjet kanë shkuar në proces të likuidimit. 'Grand Hoteli' qysh tani është i gatshëm të privatizohet edhe pse është në procedurë të likuidimit, ndërsa sa i përket 'Llamkos'-it lidhja e

AKP-së me 'Llamkos'-in ka përfunduar në momentin e shitjes", ka thënë Tolaj.

Fabrika "Llamkos" gjendet në Vushtrri dhe ajo është e destinuar për përpunimin e llamarinës. Fabrika është projektuar që të prodhojë mbi 120 000 tonë të llamarinës se zinkuar për vit. Kjo ndërmarrje ishte privatizuar dy herë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Herën e parë është privatizuar në vitin 2005, me metodën e "spin-off-it special", kurse në vitin 2009 AKP kishte bërë tërheqjen e aksioneve nga blerësi për shkak të mospërbushjes së obligimeve kontraktuale.

Përpjekja tjetër ishte realizuar në vitin 2011, kur kjo ndërmarrje ishte blerë nga një kompani angleze. Por, as kjo kompani nuk ka përmbushur obligimet dhe si rrjedhojë, që nga viti 2015 kjo

ndërmarrje është në procedurë të falimentimit. Janë rreth 500 punëtorë të cilët kanë mbetur pa punë tash e katër vjet, të cilët pretendojnë të jenë kreditorë, pasi menaxhmenti i kompanisë u ka mbetur borxh 10 paga ose në total 750 mijë euro.

"Grand Hoteli" ishte privatizuar në vitin 2006 në një vlerë mbi 8 milionë euro dhe një kontratat që obligonte blerësin e "Grand Hotelit" që të bënte investime në vlerë mbi 20 milionë euro dhe të punësonte 570 punëtorë. Por, mosrealizimi i zotimeve nga ana e blerësit bëri që kjo ndërmarrje shoqërore të hynte në paqartësi ligjore në mes blerësit të "Grand Hotelit", Zylqif Berisha, pronar i kompanisë NTP 'Unio Commerce' dhe AKP-së.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në vitin 2012 tërhoqi aksionet në ndërmarrjen e re "Grand Hotel"

dhe ktheu këtë ndërmarrje nën administrimin e vet.

Përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit konsiderojnë se lidhur me "Grand Hotelin", të gjitha procedurat gjyqësore lidhur me këtë veprim ligjor të AKP-së kanë përfunduar me vendime gjyqësore përfundimtare në favor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

"Grand Hoteli", krahasuar me të kaluarën, është pothuajse jashtë veprimtarisë për të cilën ishte destinuar në kohën kur u ndërtaua 40 vjet më parë, në vitin 1978. Aktualisht, në hapësirat e "Grand Hotelit" operojnë biznese të ndryshme, duke filluar nga shtëpi mediale, zyra për shërbime të ndryshme ligjore, të kontabilitetit, organizata të huaja, aparate bankare, hapësira reklamuese, lojëra të fatit e shërbime mjekësore.



# Asnjë veprim konkret për bankën e diasporës në Kosovë

Ndonëse prej kohësh është paralajmëruar hapja e bankës së diasporës në Kosovë, akoma asnjë veprim konkret nuk është bërë në këtë drejtim. Kryetari i rrjetit të bizneseve të diasporës në Austri, Ylli Blakaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se bizneset nga Austria janë të gatshme ta deponojnë kapitalin e tyre, por ka kërkuar që mos të ketë infiltrime politike në këtë proces. Ndërkohë ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka thënë se kjo ministri do ta mbështesë themelimin e kësaj banke



**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 JANAR - Më shumë se tre miliardë dollarë llogaritet të jetë pasuri financiare e biznesmenëve shqiptarë vetëm në Zvicër, Gjermani dhe Austri, pa llogaritur pjesën tjetër të mërgatës në mbarë botën. Për këto mjete u kërkuar që të hapet një bankë e diasporës në Kosovë në mënyrë që të multiplifikohen dhe të përfitojë ekonomia e vendit. Edhe pse ishte paralajmëruar hapja e kësaj banke më 28 nëntor të vitit të kaluar, në simbolikë të ditës së flamurit, ende nuk është bërë asnjë veprim konkret. Në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) në të cilën duhet të bëhet aplikimi, akoma askush nuk ka trokitur në derë për këtë çështje.

Për t'u hapur një bankë në Kosovë, sipas Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës, "gjatë procesit të themelimit dhe para marrjes së licencës përfundimtare, duhet të depozitohet për këtë qëllim në BQK një kapital fillestar minimal në shumë jo më pak se 7 milionë euro".

Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se çështja e bankës së diasporës ka të bëjë me vullnetin e afaristëve nga diaspora. "Çështja e bankës së diasporës ka të bëjë me disa individë dhe kompani nga diaspora që të aplikojnë. Ne do t'i mbështesim. Sa e di unë, deri më tani nuk kanë aplikuar dhe është çështje e pjesëmarrjes financiare që duhet të deponohen diku rreth 6 milionë euro. Gjithçka deri më tani ka mbetur në vullnetin e tyre. Ne me mundësitë tona do t'i përkrahim", ka thënë ministri Gashi.

Kurse kryetari i rrjetit të bizneseve të diasporës në Austri, Ylli

Blakaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se janë duke u koordinuar me rrjetin e bizneseve të diasporës dhe ka apeluar që mos të ketë ndërhyrje politike në këtë proces. Sipas tij, bizneset shqiptare të Austrisë janë të gatshme ta deponojnë shumën e tyre në bankën e diasporës. "Shoqata jonë ka pasur iniciativë për këtë bankë dhe gradualisht po diskutojmë me anëtarët tanë. Sa i përket paralajmërimit që hapja të bëhej më 28 nëntor të vitit që lamë pas, unë edhe atëherë kam menduar se është paralajmërim i ngutshëm pasi kjo çështje merr kohë. Neve na duhet bankë e diasporës në Kosovë, por që ka filialet edhe në diasporë, në mënyrë që të operojmë më lehtë. Esenca është që kapitalin e diasporës për ta shfrytëzuar në të mirë të vendit e, po ashtu, në këtë bankë të ketë edhe depozita dhe kredi", ka thënë Blakaj.

Ai ka bërë me dije se do të kenë takime edhe përpjekje për ta organizuar një forum ekonomik shqiptar të nivelit botëror. "Sa i përket fazës së aplikimit, ne jemi në pritje të konsolidimit në rrjet. Në janar kemi takime dhe do të kemi përpjekje për ta organizuar një forum ekonomik në muajin maj në nivel të rrjeteve të botës, dhe aty vendos bordi. Bizneset e Austrisë janë të gatshme që pjesën e tyre të mjeteve ta deponojnë në këtë bankë", u shpreh ai.

Blakaj ka shprehur vërejtje të rrethanat politike në vend, duke thënë se ato nuk janë të favorshme. "Kushtet politike nuk janë të favorshme pasi gjithçka po lidhet me politikë. Ata duhet të na lënë të lirë dhe të mos përzihen. Ka pasur infiltrime. Pra, dalja e ministrit të Diasporës dhe presidentit për të folur për këtë çështje nuk është e duhur", ka thënë Blakaj. Ndërkaq guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, në një inter-

vistë për gazetën "Epoka e re" pati thënë se ka hapësirë për një partneritet më të thuktë në mes të Kosovës dhe diasporës. "Duke pasur parasysh rëndësinë e diasporës, vlerësoj se ka hapësirë për një partneritet edhe më të madh ekonomik ndërmjet Kosovës dhe diasporës, duke rritur kontaktet ndërmjet institucioneve dhe afaristëve vendorë me afaristët nga diaspora, për t'i pasqyruar më për së afërmi mundësitë që i ofron ekonomia e Kosovës", ka thënë Mehmeti, duke shtuar se BQK-ja mirëpret investimet e mundshme nga diaspora në sistemin financiar. "BQK-ja është e gatshme të mbështesë, me të gjitha kapacitetet e saj, çdo iniciativë për të investuar në Kosovë. Për këtë qëllim ne kemi mirëpritur një iniciativë të tillë, jemi takuar me iniciatorët dhe i kemi informuar lidhur me kërkesat ligjore të BQK-së për licencimin e një banke", u

shpreh ai.

Njohësi i çështjeve ekonomike që për dy mandate udhëhoqi Odën Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se diaspora ka rëndësi shumë dimensionale. "Diaspora shqiptare kudo në botë është e anashkaluar dhe për të flitet vetëm në fushata zgjedhore. Duhet të kuptohet se mëkati më i madh që i bëhet diasporës është që analizohet më shumë nga dimensionin financiar sesa një vlerë intelektuale dhe edukative. Është diskutuar shumë herë për krijimin e një banke të diasporës. Duhet të kuptohet se ata janë ambasadorët më të mirë të Kosovës. Kushti i parë për një bankë të tillë është stabiliteti dhe politika dhe sundimi i rendit dhe ligjit. Kjo është një ndër sëmundjet më të mëdha që i kanoset aktualitetit ekonomik", ka thënë ai.

Gërxhaliu ka përmendur edhe përfitimet potenciale që mund

të kishim nga kjo bankë. "Përfitimet nga banka e diasporës do të ishin shumë dimensionale, si në aspektin ekonomik ashtu edhe atë integruar. Sa më shpejt ta kemi këtë bankë, shumë procese do të marrin kahe pozitive. Nuk mund të imagjinojmë projektet e mëdha si Kosova e Re dhe projekte të tjera pa ndihmën e diasporës. Në Zvicër, Gjermani dhe Austri, janë më shumë se tre miliardë kapital i diasporës. Imagjinojeni çfarë katalizatori ekonomik do të kishim sikur t'u krijonim kushte për të investuar në Kosovë", ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se BQK-ja duhet të jetë më solide sa iu përket kushteve të licencimit të kësaj banke. "BQK-ja me rastin e aplikimit, për hir që është kapital i diasporës, duhet të ketë kushte më të volitshme. BQK-ja duhet të jetë funksionale dhe të ketë trajtim të veçantë në këtë drejtim", ka thënë Gërxhaliu.



## Begaj e zyrtari danez flasin për mundësitë e bashkëpunimit

**MALISHEVË, 6 JANAR (ER)** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur në një takim pune ish-vëzhguesin e Bashkimit Evropian (BE) nga Danimarka, Stig Skovbo, me të cilin ka biseduar për zhvillimet në Malishevë dhe për mundësitë e bashkëpunimit në mes të kësaj komune dhe qyteteve në Danimarkë.

Kryetari Begaj e ka falënderuar zyrtarin danez Stig Skovbo për

vizitën e tij dhe e ka njoftuar atë me zhvillimet në Komunën e Malishevës, të arriturat, sfidat dhe nevojat që ka kjo komunë. Nga ana tjetër, Stig Skovbo është shprehur i kënaqur me të arriturat dhe zhvillimet e përgjithshme në Malishevë dhe ka shprehur gatishmërinë e tij për të krijuar lidhje në mes të Malishevës dhe vendeve në Danimarkë me qëllim të krijimit bashkëpunimit të ndërsjellë.



## Mbi një milion euro do të jetë buxheti për bujqësi në Rahovec

**RAHOVEC, 6 DHJETOR** - Dëmet nga vërshimet që janë shkaktuar në bujqësi në Rahovec në vitin që lamë pas do të kompensohen nga Qeveria e Kosovës, ndërkohë sa iu përket masave për parandalimin e dëmeve të tilla pritet të bëhet një plan. Buxheti që kjo komunë ka ndarë në bujqësi, fushë kjo që e ka më të

zhvilluarën, është mbi një milion euro.

Kryetari i kësaj komune, Smajl Latifi, në një intervistë për "Kosovapress" ka folur edhe për arsimin në këtë komunë, duke bërë me dije edhe për çerdhet që do të ndërtohen. Latifi ka e vlerësuar si sukses të qeverisjes së tij zonën ekonomike prej 36

hektarësh në Opertushë të Rahovecit, zonë kjo që, siç ka thënë ai, do të ndikojë në tërheqjen e investitorëve, zhvillimin ekonomik të Rahovecit dhe në punësimin e qytetarëve. Për këtë të arritur dhe për të tjera projekte kryetari Latifi ka thënë se e ka marrë mbështetjen e Qeverisë.

## Mitrovica bëhet me parking nëntokësor

**MITROVICË, 6 JANAR (ER)** - Në Mitrovicë është bërë ceremonia e hapjes së parkingut nëntokësor i cili posedon ambientet më moderne të parkimit për të gjithë drejtuesit e automjeteve. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm kryetari i komunës, Agim Bahtiri, nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, zëvendësministri i Ministrisë

së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Gjergj Beka, zëvendësministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Sami Zeka, drejtorë të drejtorive komunale dhe zyrtarë të tjerë komunalë.

Në fjalën e tij kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka thënë se ndihet i nderuar dhe i privilegjuar që është në inaugurimin dhe përirimin e një



parking nëntokësor me standarde evropiane dhe moderne, i cili ka qenë mjaft i nevojshëm për qytetin tonë. Po ashtu, kryetari Bahtiri i ka ftuar të gjithë qytetarët ta shfrytëzojnë këtë parking nëntokësor i cili ofron jo vetëm çmime të lira, por njëkohësisht standarde dhe siguri për veturat e tyre.

Me theks të veçantë kryetari Bahtiri ka thënë se këtë pronë

komunale e ka dhënë në shfrytëzim, pikërisht duke e parë mungesën e parkingjeve ku mund të vendosen veturat, në këtë mënyrë do të lehtësohet qarkullimi i automjeteve nëpër rrugët kryesore të qytetit dhe mitrovicasit të kenë mundësi të kryejnë shërbimet në vendin e tyre pa pasur problem ku ta lënë veturën.

Ndërsa pronari i Kompanisë "NTP Tropik" ka thënë se ndi-

het shumë falënderues për mbështetjen e vazhdueshme që ka pasur nga Komuna e Mitrovicës, të cilët, sipas mundësive të tyre, po ndihmojnë zhvillimin e bizneseve dhe rritjen e punësimit.

Ky parking nëntokësor është ndërtuar në bazë të standardeve evropiane, i cili ka kamera, ndriçim dhe siguri maksimale si dhe ofron mundësi për parkim të rreth 50 veturave.

## Inaugurohet klinika "Swiss Clinique 2" në Gjilan

**GJILAN, 6 JANAR (ER)** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka marrë pjesë në inaugurimin e klinikës "Swiss Clinique 2", e cila ka një staf vendor dhe ndërkombëtar prej 53 personave. Me këtë rast, Haziri nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka shkruar se kjo klinikë do të bëhet krenaria e

Gjilanit. "Pata nderin që së bashku me pronarin, Bari Kastrati dhe mjekun zviceran, dr. Aissa Hachler Boudramma, ta inaugurojmë njërin prej klinikave më të avancuara në rajon 'Swiss Clinique 2', e cila ka staf vendor dhe ndërkombëtar prej 53 vetave. Është një prej shërbimeve shëndetësore

më të mëdha që regjioni ynë tashmë e ka, ku përfshihet edhe Kumanova, Presheva dhe Bujanoci. Besoj shumë që 'Swiss Clinique 2' do të bëhet krenaria e Gjilanit. Urime familjes Kastrati dhe faleminderit që është bërë një nga investitorët më të mëdhenj në Gjilan!", ka shkruar Haziri.





# Narkoza e vizave - mit apo realitet (10)



Shkruan: Agron HOTI

## Paradoksi

Paradoksi ndodhi kur Tribunali i Hagës si duket nuk mjaftoi për hetime të gjoja krimeve të luftës, Këshilli i Evropës përmes Raportit të Dick Martyt dëmtoi rëndë luftën çlirimtare të Kosovës të bërë kundër Serbisë, si rezultat i të cilit u themelua Gjykata Speciale për Krime Luftë si rast i paprecedentë në botë. Thua ti se Tribunalin e Hagës e ndalonte ndokush që të arrestonte dhe dënonte këdo nga Kosova. Si mund ta pengonin shqiptarët funksionimin e Tribunalit të Hagës, kur ata bashkëpunonin plotësisht me të?! Si mund ta pengonin themelimin e Gjykatës Speciale kur vetë Parlamenti ynë e votoi atë?! Ndërsa ishin serbët dhe tërë rajoni që fshihnin kriminelët dhe nuk bashkëpunonin. Dhe shqiptarët e Kosovës e përpin edhe këtë të keqe të pariparueshme, vetëm që ta japin shembullin demokratik, se jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me çdo segment të bashkësisë ndërkombëtare. Askush nuk e vlerësoi

këtë akt të pashembullt të Kosovës. E absurditeti rritet kur na thuhet se kjo gjykatë është e Kosovës e në anën tjetër pritet të operojë nga Holanda.

Pse nuk na thuhet nga BE se kjo Gjykata Speciale u themelua si rezultat i lobimit të madh serb e rus, të cilëve Këshilli i Evropës u kishte mbetur mekanizmi i vetëm ndërkombëtar ku mund të shtynin përpara një rend-ditë të rrezikshme dhe poshtëruese për Kosovën?! Dhe kjo u bë sepse Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë, institucion ky i Kombeve të Bashkuara, i ndërpreu çdo rrugë të mëtejme të Serbisë dhe aleatëve të saj për të kontestuar pavarësinë e Kosovës. Prandaj, Serbia kërkonte rrugë alternative për të dërmuar imazhin dhe të ardhmen e Kosovës, e Këshilli i Evropës ishte rasti ideal, të cilin serbët edhe e shfrytëzuan. E në Këshillin e Evropës kanë ndikim të madh dhe mundësi në numra vendet satelite të Ruisë. Dhe ashtu në fakt ndodhi, kur të gjithë satelitët e Ruisë votuan Raportin e Dick Martyt.

Në qoftë se bashkësia ndërkombëtare dhe veçanërisht BE kritikojnë vazhdimisht Kosovën për sundim joefektiv të ligjit, pse BE-ja përmes misionit të EULEX-it nuk u mor asnjëherë me rastet e privatizimit, në të cilat flitet se ka vluar korrupsioni dhe krimi i

organizuar?! E dihet që privatizimi dhe zhvillimi ekonomik i vendit menaxhohej nga shtylla e katërt e UNMIK-u gjatë periudhës 2000-2008.

Shtylla e katërt e UNMIK-ut ishte vetë BE-ja nën autoritetin e OKB-së, ndërsa vala më e madhe e privatizimeve në Kosovë shikuar në vlerë monetare kishte ndodhur gjatë vitit 2004-2007, pra pikërisht në kohën kur tërë procesi i privatizimit menaxhohej nga BE-ja. Perceptimi në Kosovën UNMIK-iane ishte se gjatë asaj kohe ishte i pafund numri i ndërkombëtarëve që ishin zhytur në afëra korruptive gjatë privatizimit të aseteve të Kosovës dhe kurrë askush nuk u mor me këto raste. Rasti i privatizimit të Ferronikelit ishte vetëm maja e ajsbergut.

Qytetarët e Kosovës, të hutuar nga krahurat e pafundta të UNMIK-ut dhe kombinimeve të mëpastajme, edhe sot e kanë të ngulitur në kokë perceptimin se korrupsioni nuk ka vend mes ndërkombëtarëve që punojnë në Kosovë dhe se korrupsioni vendin e ka vetëm te vendorët. Sigurisht që perceptimi është se vendorët janë të korruptuar, por hiç më pak nuk ishin ndërkombëtarët me afëra të panumërta euro multimilionëshe.

Si ka mundësi që UNMIK-u asnjëherë nuk ndërtoi politika për privatizim dhe çështje pronësore?! A u bë qëllimshëm kjo apo jo?! Në interes të kujt ishte de-industrializimi i tërë-

sishëm i Kosovës?! Në çdo vend të botës së pari bëhen politikat, legjislacioni për t'i dhënë orientim një fushe të caktuar, e pastaj konform legjislacionit themelohen strukturat zbatuese dhe mbikëqyrëse.

E UNMIK-u në Kosovë, s'u mor fare me politika e legjislacion, por direkt u fut në zbatim të projekteve të errëta të privatizimit të atyre aseteve që qytetarët e Kosovës me shumë mund e sakrificë i kishin ndërtuar dhe mirëmbajtur. Pra, themeloi Agjencinë e Mirëbesimit dhe Agjencinë e Pronave, të cilat patën efekte shkatërruese për ekonominë e vdekur të Kosovës. E për këtë shkatërrim afatgjatë të ekonomisë kosovare, pasojat e të së cilës do zgjasin me vite, askush nga UNMIK-u nuk u mbajt përgjegjës.

Qytetarët e Kosovës sot me të drejtë ankohen për mbylljen e gjithë atyre fabrikave në tërë Kosovën, kur pritet ishin që UNMIK-u i stërfuqishëm pushtetshmërisht, për 9 vjet udhëheqje (1999-2008) do ta re-vitalizonte ekonominë e Kosovës. Mirëpo, misionet e Kombeve të Bashkuara gjithmonë kanë vepruar kështu, sa herë janë tërhequr nga zona të ndryshme në glob kanë qenë tërësisht të pasuksesshëm dhe për këtë dështim të tyre fajin gjithmonë ua kanë hedhur vendorëve, pra tradita e keqe vazhdon.

Nëse Kosovës i kërkohet përgjegjësi, e cila në fakt edhe

duhet kërkuar, atëherë përgjegjësia duhet kërkuar edhe te UNMIK-u dhe EULEX-i, sepse kjo do të tregonte se çdo e arritur dhe pa-arritur që ka ndodhur në Kosovë prej pas luftës e deri më sot është rezultat i një konglomerati të qeverisjeve vendore e ndërkombëtare duke bërë që shpesh askush për askushin të mos e dinte se çfarë bënte, ndërkohë që perspektiva për qytetarët e këtij vendi vazhdonte të mbahej peng.

Kosova nuk ishte ekonomi gjermane që të mund t'i përballonte efektet negative të privatizimit të keq dhe keqmenaxhimit të pronave. Për Kosovën çdo centimetër apo gram ekonomi kishte dhe ka rëndësi sepse Kosova ka ekonomi shumë të vogël. Dhe sigurisht që de-industrializimi, keqprivatizimi dhe keqmenaxhimi i pronës, të mbledhura të gjitha së bashku, do t'u bënin dëm edhe ekonomive më të forta në glob, kurse Kosovën e shkatërruan tërësisht.

E tani është shumë lehtë t'u lihet faji shqiptarëve për dështimet ekonomike të njëpasnjëshme të UNMIK-ut. E kur një punë nisët keq, siç ishin politikat de-ekonomizuese të UNMIK-ut, atëherë është shumë e vështirë t'i kthesh gjërat në binarë. Ç'është e vërteta as politika e Kosovës nuk është se pati ndonjë vizion të qartë në këtë drejtim, prandaj edhe shkuan gjërat keq. (Vijon)

## The Schengen Visa Countries





## Ergodani dhe Putini pritet të takohen gjatë këtij muaji

ANKARA, 6 JANAR - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan dhe homologu i tij rus, Vladimir Putin, pritet të takohen ku temë kryesore e bisedimeve pritet të jetë vendimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për t'i tërhequr trupat nga Siria.

Takimi Erdogan - Putin pritet të

mbahet gjatë këtij muaji, ka raportuar agjencia shtetërore e lajmeve turke, Anadolu. Zëdhënësi i Putinit, Dmitry Peskov ka thënë po ashtu se të dy presidentët janë pajtuar që të mbajnë një takim së shpejti. Erdogan dhe Putini herën e fundit ishin takuar në margjinat e samitit G-20 që u mbajt në Buenos

Aires më 1 dhjetor, 2018.

Turqia mbështet grupet rebele opozitare në Siri, ndërkaq Rusia dhe Irani mbështesin Qeverinë e presidentit sirian, Bashar al-Assad. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, më 20 dhjetor 2018 njoftoi se do t'i tërheqë trupat amerikane nga Siria.



## Trumpi: Nuk është bërë përparim në takim me udhëheqësit e Kongresit

Presidenti i ShBA-së, Donald Trumpi, ka thënë se pas shumë dekadash duhet t'i zgjidhim përfundimisht problemet me kufirin jugor, duke kërkuar sërish fonde që të ndërtohet muri përgjatë kufirit ShBA - Meksikë, gjë që kundërshtohet fuqishëm nga demokratët

WASHINGTON, 6 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë se "nuk është bërë shumë përparim" pasi udhëheqësit e Kongresit nuk plotësuan kërkesat e presidentit për ta ndërtuar murin në kufi me Meksikën, financimin e së cilës Trumpi e ka futur në buxhet. Ndërtimi i murit ka qenë shkaktari i mbylljes së pjeshme të

Qeverisë amerikane.

Më 5 janar Trumpi shkroi në "Twitter" se edhe një takim do të mbahet më 6 janar për këtë çështje. "Pas shumë dekadash duhet t'i zgjidhim përfundimisht problemet me kufirin jugor", ka shkruar ai, duke kërkuar sërish fonde të ndërtohet muri përgjatë kufirit ShBA - Meksikë, gjë që kundërshtohet fuqishëm nga



demokratët. Më herët, nën-presidenti amerikan Mike Pence ka thënë se takimi në Shtëpinë e Bardhë ndërmjet zyrtarëve të administratës dhe zyrtarëve të Kongresit "ka qenë produktiv". Në takim kanë qenë të pran-

ishëm pjesëtarë të stafit të Kongresit dhe jo liderët kryesorë demokratë. Aty, po ashtu, nuk kanë marrë pjesë as Trumpi dhe as Pence. Trumpi po kërkon 5.6 miliardë dollarë fonde për ndërtimin e murit me Meksikën, ndërkaq demokratët

në Kongres kanë refuzuar të shpenzojnë buxhet për ndërtimin e tij.

Më 4 janar presidenti Trump kishte thënë se do të vazhdojë të mbajë pjesërisht të mbyllur Qeverinë "për muaj apo edhe vite", derisa të plotësohet kërkesa e tij. Sipas presidentit amerikan, ndërtimi i murit është i nevojshëm për ndaljen e migrantëve ilegalë dhe kontrabandës së drogave. Demokratët thonë se kjo do të ishte një mënyrë joefikase për ta luftuar migracionin e paligjshëm dhe trafikimin e drogës.

Gjatë fushatës për zgjedhjet presidenciale më 2016, Trumpi ishte zotuar se Meksika do të paguajë për ndërtimin e murit, por Meksika ka refuzuar të bëjë një gjë të tillë.

## Talebanët konfirmojnë zhvillimin e bisedimeve me ShBA-në

KABUL, 6 JANAR - Talebanët njoftuan se vazhdon angazhimi i tyre me Shtetet e Bashkuara për të negociuar dhënien fund të një "luftë dhe pushtimi të paligjshëm" të Afganistanit, duke përjashtuar kështu çfarëdoj bisedimesh të drejtpërdrejta me qeverinë në Kabul. Zëdhënësi i talebanëve,


Zabihullah Mujahid, tha se po shqyrtohet opsioni i një raundi të ri bisedimesh me Shtetet e Bashkuara, por se nuk janë përcaktuar ende data dhe vendndodhja. Ai foli në reagim të njoftimeve, të cilat i quajti "pretendime false", se negociatorët e palës rebele synojnë të zhvillojnë këtë muaj në Arabinë

Saudite bisedime të drejtpërdrejta me zyrtarët afganë. Përfaqësuesi special amerikan për Afganistanin, Zalmay Khalilzad, zhvilloi dy raunde maratonë bisedimesh në muajin dhjetor me një delegacion të lartë talebanësh në Abu Dhabi, ku ishin të pranishëm edhe të dërguarit e Arabisë Saudite,

Pakistanit dhe Emirateve të Bashkuara Arabe. Zëdhënësi taleban u shpreh me optimizëm në mediet sociale për rezultatet e negociatave me palën amerikane. Siç është njoftuar, presidenti Donald Trump është duke shqyrtuar opsionet për reduktimin e ndjeshëm të mbi 14 mijë

ushtarakëve amerikanë që shërbejnë në Afganistan. Këto njoftime shqetësuan zyrtarët në Kabul dhe kritikët ndërkombëtarë, të cilët thonë se një tërheqje amerikane nuk do t'i linte arsye talebanëve për të ndaluar luftimet dhe për të kërkuar një zgjidhje të negociuar të luftës.

## ShBA-ja kushtëzon tërheqjen e trupave nga Siria



WASHINGTON, 6 JANAR - Shtetet e Bashkuara ka thënë se vendimi i saj për t'i tërhequr trupat nga Siria është kushtëzuar me atë që Turqia të ofrojë siguri për kurdët në Siri. Kështu ka thënë këshilltari për siguri kombëtare i ShBA-së, John Bolton.

Gjatë vizitës së tij në Izrael, Bolton po ashtu ka thënë se tërheqja e ShBA-së është kushtëzuar edhe me mposhtjen e militantëve të mbetur të Shtetit Islamik në Siri. Boltoni është shprehur se nuk ka një afat të caktuar se kur ShBA-ja do t'i tërheqë trupat e saj nga

Siria. "Afati për tërheqjen e trupave varet nga vendimet politike që ne duhet të zbatojmë", ka thënë ai, duke shtuar se presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump "dëshiron që kalifati i IS-it të shkatërrohet".

Në një video-mesazh të postuar në "Twitter" më 20 dhjetor, 2018, Trumpi kishte thënë se trupat amerikane po kthehen. "Ne kemi fituar kundër IS-it. Ne i kemi mposhtur", kishte thënë ai. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis, kishte dhënë dorëheqje pas vendimit të Trumpit për

tërheqjen e trupave, teksa aleatët e NATO-s, përfshirë Francën dhe Gjermaninë, kishin thënë se ndryshimi drastik i kursit të ShBA-së ka vënë në rrezik luftën kundër IS-it dhe po ashtu ka vënë në rrezik milicite kurde, të cilët kanë punuar me forcat amerikane në luftën kundër militantëve të IS-it.

Komentet e Boltonit janë të parat që konfirmojnë nga administrata amerikane se plani i tërheqjes së trupave është shtyrë, pasi që fillimisht mendohej se trupat do të tërhiqeshin brenda javësh.

## Jep dorëheqje shefi i stafit të Pentagonit

WASHINGTON, 6 JANAR - Shefi i stafit të Departamentit amerikan të Mbrojtjes, Kevin Sweeney ka dhënë dorëheqje, vetëm një muaj pasi James Mattis u largua nga pozita e

Sekretari të Mbrojtjes. Admirali Sweeney përmes një deklarate tha se "është koha e duhur që të kthehem të punoj në sektorin provat". Në letrën e tij të dorëheqjes ai ka shkruar se

"ka qenë nder" që ka shërbyer përkrah kolegëve të tij në këtë departament, raporton BBC. Sweeney është zyrtari i tretë i lartë në Pentagon që ka dhënë dorëheqje, që prej se presidenti

amerikan, Donald Trump njoftoi se do të tërheqë trupat nga Siria. Admirali Sweeney ka qenë në postin e shefit të stafit të Pentagonit që prej janarit të vitit 2017.





Dy kryediplomatët e Shqipërisë nga Kosova

# HASAN PRISHTINA DHE GENT CAKAJ



Ismet SYLEJMANI

Historia e popullit shqiptar është e mbushur me shume ngjarje të mëdha dhe te lavdishme, me personazhe të mëdha brenda sajë, të cilat me veprimtaritë e tyre kanë luajtur rol të madh dhe kane shkaktuar lëkundje shumë goditëse, të cilat kanë rezultuar me debate të mëdha, dorëheqje e largime të shumta, me akuzë e kundërakuza, me sharje dhe fyryje nga më të ultat, me vleresime e nënqmime nga më të ndryshmet!

Në Shqipëri që kur është shpallur Pavarësia e sajë në Vlorë prej vitit 1912 e kënde, kanë dalur shumë qeveri njëra pas tjetrës, të cilat në kabinetet e tyre kanë pasur personalitete nga më të veçantat që kanë ardhur nga profile të ndryshme por edhe nga qytete e krahina të Shqipërisë politike dhe trojeve të mbetura jashtë sajë!

Pas Isa Boletinit për të cilin kurrë nuk dihet saktë se cili ishte roli dhe pozita e tij në Qeverinë e Ismail Qemalit, në qeveritë tjera të Shqipërisë përpos patriotit të madh kombëtar Hasan Prishtina që 6 ditë ishte Kryeminister i Qeverisë së Shqipërisë dhe Ministër i Puneve të Jashtme, kurrë më nuk pati një tjetër anëtarë të lartë qeverie nga Kosova! Gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare në Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri të udhëhequr e të komanduar nga Enver Hoxha, në Komitetin Qendror të PKSH-së dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare ishte shqiptari nga Kosova Ramadan Çitaku, kurse dihet nga të gjithë se nuk ishte e mundur që të lejohej një personalitet shqiptar nga Kosova që të përfshihej në udhëheqjen e lartë në Qeverinë e Shqipërisë dhe njëkohësisht të vazhdonte të jetonte në mënyrë normale në Kosovë, ngase Serbia pushtuese dhe aleatët e sajë në ish-Jugosllavi, një dicka të tillë nuk do të lejonin!

Ndryshimet politike në Shqipëri pas vitit 1990 e deri te qeveria e Kryeministrit Rama, ndonëse propagandohej me shumë pompozitet, se këto zhvillime kishin sjellur në pushtet klasen politike që ishte prokosovare të demokratëve, nuk sollën në këtë drejtim asgjë të re dhe nuk pati asgjë për tu shënuar dhe për tu mbajtur mend!

Fillimi i luftës së armatosur të UÇK-së, ndihma e madhe dhe bombardimi i NATO-s mbi caqet ushtarako-police nëpër teritoret e luftës në Kosovë dhe në gjithë Serbinë, dhe përfundimi i luftës me largimin e Serbisë pushtuese nga Kosova, solli realitete të reja për popullin shqiptar në Ballkan!

Në vitin 2008 Kosova shpall Pavarësinë e saj dhe u bë shtet i pavarur dhe sovran të cilin e njohën dhe e pranuan mbi 100 shtete të

botës duke veqar që në mesin dhe ndër të parat ishin SHBA-të, Anglia, Gjermani, Franca, Italia, Holanda etj!

Në udhëheqjet e qeverive të Shqipërisë defiluan shumë kryeministra e ministra nga të gjitha anët dhe të profileve të ndryshme!

Por historia nuk njih asnjë rast tjetër, që në qeveritë shqiptare të kenë pasur funksione të larta me perjashtim të figurës së madhe atdhetare të Hasan Prishtinës!

Ardhja e Edi Ramës Kryeministër i Qeverisë së Shqipërisë dhe atë në mandatin e tij të dytë, solli risitë e mëdha dhe të panjohura që nga epoka e Hasan Prishtinës!

Kryeministri Rama, në hapin e parë paralajmëroi se në përbërjen e kabinetit të tij qeveritar do të angazhonte personalitete të fushave të ndryshme, dhe në funksion të kësaj, nga Kosova angazhoi personalitete në nivel të zv. ministrave!

Angazhimi dhe caktimi i zv. ministrave sado që ishte në ministri relevante, nga shumë analist e vlerësues u pa si fushatë elektorale dhe me një angazhim për të amortizuar para faktorit relevant ndërkombëtar përpjekjen e partive politike shqiptare në Kosovë dhe Luginë të Preshevës për bashkim me Shqipërinë të viseve shqiptare të aneksuar dikur ish-Jugosllavisë përkatësisht Serbisë.

Por reformatimi i Qeverisë së Shqipërisë nga Kryeministri Rama, në dhjetor të vitit 2018 që sapo e lamë pas dhe caktimi i dy ministrave nga Kosova përkatësisht dhënia e personaliteteve nga Kosova të drejtojnë me ministrinë e jashtme dhe të ministrisë së arsimit, sportit dhe rinisë, kjo është kulmi i ndryshimit të madh dhe këtë koha do ta dëshmojë, se a do të jetë vendim historik e cilësor apo jo, koha do ta dëshmojë se sa do të jetë progresive apo jo, koha do ta dëshmojë se sa do të jetë përparimtare dhe në funksion të bashkimit kombëtar të ëndërruar nga të gjitha gjeneratat deri më tani! Emrimi i shqiptarit nga Kosova Gent Cakaj për të udhëhequr me diplomacinë shqiptare, por edhe i shqiptares nga Kosova Besa Shahinit për të udhëhequr me arsimin, sportin dhe rininë, këto janë padyshim vendime dhe hapa të mëdhenj të Kryeministrit të Qeverisë së Shqipërisë Edi Rama në veçanti por edhe fitore e madhe e forcave progresive për bashkim me Shqipërinë!

Lajm i medh ishte kur doli në mjetet e informimit se Minister i Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë do të jetë shqiptari nga Kosova Gent Cakaj! Gjithashtu lajm i madh ishte kur doli në mjetet e informimit se Minister i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Shqipërisë do të jetë shqiptarja nga Kosova Besa Shahini!

Këto emrime pavarësisht nga kualiteti janë apo jo të qëlluara, sa i perket personaliteteve dhe vendeve prej nga vijnë, janë paralajmërimet për ndryshime të mëdha të funksionimit në të ardhmen të të gjitha kabineteve qeveritare të Shqipërisë! Ndoshka praktika të tilla do të

ndjeken nga ana e kabineteve qeveritare të Shqipërisë edhe me shqiptarët në Maqedoni, me shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe ata të Malit të Zi!

Apo edhe Qeveria e Kosovës do të angazhojë në radhët e saja personalitete shqiptare e figura të shquara nga Shqipëria, Maqedonia, Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi!

Apo edhe partneri shqiptar i koalicionit qeverisës në Maqedoni do të ndjekë një shembull dhe praktikë të tillë ku do të angazhojë personalitete shqiptare nga Shqipëria, Kosova, Lugina e Preshevës dhe nga Mali i Zi!

Derisa të percaktohet saktë e me ligje e kushtetutë, lejohet apo jo angazhimi dhe ngritja në përgjegjësi për ushtrime të larta të angazhimeve në rangje ministrash e zv.ministrash apo edhe ambasador në vende të ndryshme, Shqipëria prinë si zakonisht nëpër histori!

Por deri në të ardhmen që mund të presim me kureshtje se çfarë do të ndodhë, mund të konstatojmë, se një nga ngjarjet e mëdha të vitit 2018 në Shqipëri, me jehonë të madhe ishte emrimi i këtyre dy dikastereve me personalitete nga Kosova!

Ndërkaq e veçanta dhe spektakularja është se pas patriotit të madh të kombit Hasan Prishtina, Gent Cakaj nga Kosova, është Ministri i dytë i Punëve të Jashtme në historinë e diplomacisë së Qeverisë së Shqipërisë!

Hasan Prishtina ishte nga fsh. Polaci Drenicës, kurse Gent Cakaj është me prejardhje nga Gjakova, i lindur dhe i rritur në Prishtinë!

Këto emrime dhe zgjidhje të Kryeministrit Rama, janë të mëdha dhe historike, sepse për herë të parë që nga koha e qeverisë hasaniste, Kosova udhëheqë edhe me Diplomacinë edhe me Arsimin e Shqipërisë!

Ky realitet i madh jo vetëm është produkt i luftës heroike çlirimtare që ka zhvilluar popullit shqiptar i Kosovës dhe viseve të saja në emblemen e UÇK-së, ku me ndihmen permanente të Nanës Shqipëri dhe aleateve tanë të mëdhenj SHBA etj., kemi fituar luftën kundër Serbisë pushtuese, prandaj kjo klimë e re postçlirimtare ka sjellë edhe zhvillime të mëdha pozitive që edhe optimistët më të mëdhenj kurrë nuk do të kishin mundur ta imagjinonin se do të vinte ndonjëherë!

Dy kryediplomatët të Shqipërisë në kohëra e periudha të ndryshme, Hasan Prishtina e Gent Cakaj, te dytë të Kosovës, njeri i Drenicës e tjetri i Gjakovës!

Hasan Prishtina dhe Gent Cakaj dy gjenerata të largëta mes vete, brenda të cilëve Kosova kjo krahinë famëmadhe e Atdheut, ka lindur dhe rritur djem e burra të lavdishëm, të cilët ia kanë rritur namnin dhe ia kanë zbardhur faqen kombit shqiptar. Njëri vinte nga shkolla dhe diplomacia turke, kjo pse vendi i tij ishte i pushtuar nga Turqia, kurse tjetri vjen nga shkolla e kohës se qeverisjes botërore në vendin e tij në Kosovë! Njëri ishte organizator dhe intelektual e atdhetar popullor që marrjen e pushtetit politik dhe udhëheqjen



HASAN PRISHTINA

GENT CAKAJ

me qeverinë dhe diplomacinë shqiptare e kishte objektiv për ta çliruar dhe zhvilluar e përparuar dhe bashkimin e Shqipërisë me pjesët e ndara të saja, dhe për ta çliruar e shpëtuar Kosovën nga zgjedha serbe, kurse Genti vjen në krye të diplomacisë shqiptare jo pse ka parti politike apo mbështetje politike shtetërore nga Kosova sikur kishte Hasan Prishtina, ngase po ta gëzonte një epërsi të tillë do të ishte fillimisht pjesë e kabinetit qeveritar të Kosovës!

Hasan Prishtinën historia dëshmon se e kanë përkrahur dhe e kanë mbështetur figurat dhe personalitetet e mëdha të Shqipërisë, por edhe pse e kanë deleguar nga baza e popullit për të udhëhequr e për të drejtuar me fatet e Atdheut, ka pasur shumë që edhe e kanë xhelozuar dhe më shumë se kaq edhe e kanë penguar dhe sabotuar, por kjo edhe atëherë ishte sot justifikohet sepse, atëherë ishte Shqipëria e dalur nga pushtimi 5 shekullor turk, ndërsa ndaj Kosovës vendlindjes së Hasanit po niste mbi supet e saj pushtimi i ri serb, e ky pushtim do të ishte pengesë për ecjen përpara të asaj Shqipërie të dalur nga Pavarësia e 1912!

Qarqet shoviniste serbe dhe armiqtë e kombit shqiptar kudo që janë, do ta kenë pritur emrimin e shqiptarit nga Kosova shef të diplomacisë së Shqipërisë, si lajmin e parë të zi të vitit 2019!

Ky emrim i madh dhe historik, për Serbinë pushtuese do të jetë thike në zemër, pasi përfundimisht ajo tash do të ketë edhe më shumë tollovi në kampin e qadrës së sajë, sepse përballë do të ketë dy Kosova e një Shqipëri, dhe kjo në diplomaci është më shumë se sa një fitore e madhe!

Ndaj Gent Cakaj sot, njëjt sikurse ndaj Hasan Prishtinës në të kaluarën, mund të ketë kundërshtime, do të ketë ndërskamca e prapaska, do të ketë edhe xhelozitë e edhe përbuzje, ndonëse për dallim nga Hasan Prishtina i madh e i lavdishëm, Genti e ka shumë më lehtë, skajshmërishtë e ka shumë më lehtë, sepse e ka përkrahje dhe mbështetje e fuqishme të Kryeministrit të Shqipërisë, që padyshim se është përparësi e madhe, që e bën që në start fillimin e madh dhe të suksesshëm të kryediplomatit të ri të Shqipërisë!

Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë Gent Cakaj në veçanti dhe bashk edhe me Besa Shahinin Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Shqipërisë, janë fillimi i madh i vitit të ri 2019!

Me këto emërime të rëndësishme dhe të guximshme politike, hasanizmi si filozofi dhe praktikë përparimtare për bashkim kombëtar, ka shënuar sukses të mëdha në arenën e politikës qeveritare dhe diplomatike shqiptare në fillim të vitit 2019!

Kosova sikur në epokën e ndritur të Hasan Prishtinës, nëpër histori ka dhënë shumë për Shqipërinë, që u dëshmuar në LANÇ, në luftën e UÇK-së, në pjesëmarrjen e sportistëve kosovar në lojrat për kombëtaren shqiptare e tash edhe në politikën aktive ditore e të planifikuar e projektuar kombëtare!

Po rritemi e po zgjerohemi, po ecim përpara e po dëshmojmë se jo vetëm të vetëm, por edhe të bashkuar dijmë të prosperojmë e përparojmë, e kurrë më nuk mund të na ndalin ata që ia kanë dashur dhe ia duan të keqen Shqipërisë dhe shqiptarëve!

Hasan Prishtina dhe Gent Cakaj, dy kryediplomatët e Shqipërisë nga Kosova!

Me Gentin dhe Besën në Qeveri, kjo dëshmon dhe tregon se Shqipëria po ndryshon në mendësinë politike, realitet i ri ky që na dërgon me shpejtësi zëri në ambientin integruar e progresiv euroatlantik.

Këto emërime janë fitore për Kosovën, ta shohim si do të priten në Shqipëri dhe sa do ta ndihmojnë dhe prosperojnë dy personalitetet nga Kosova në kabinetin qeveritar të Kryeministrit Rama!

Shkrimi im nuk do të duhej të kuptohej si shkrim lokalist, sepse parametrat matës të intelektualizmit dhe profesionlizmit të kryediplomatit të ri të Shqipërisë janë fakte, e këto janë ato që e argumentojnë dhe e dëshmojnë të kundërtën.

Lavdi e perjetshme jetës dhe veprës se patriotit të madh Kryeministrit dhe kryediplomatit të Qeverisë së Shqipërisë Hasan Prishtina! Suksese kryediplomatit të Shqipërisë, kosovarit Gent Cakaj! Suksese dhe punë te mbarë Ministrav nga Kosova në Qeverinë e Shqipërisë Gent Cakaj dhe Besa Shahini!

Prishtinë, me 5 Janar 2019!



E jashtëzakonshme

## Gruaja shet burrin online për 18 euro

E zhgënjyer nga bashkëjetesa, një grua 40-vjeçare vendosi ta shiste burrin e saj në Ebay, për shumën modeste prej 18 eurosh. Çmimi ishte i negociueshëm. Kjo ndodhi në Ditën e Krishtlindjeve në Hamburg, Gjermani, siç raportohet nga "Berliner Morgenpost", për të cilën gruaja tha se kishte marrë disa përgjigje pozitive në njoftimin e saj: "Njoftimi shkoi



shumë mirë, kam pasur përgjigje shumë pozitive", ka treguar zonja e kënaqur nga suksesi.

FOTO E DITES



Një vizitor në Festivalin Vjetor të Akullit në qytetin verior të Harbin, Heilongjiang, Kinë. Fotografia është realizuar nga Tyrone Siu, "Reuters".

E rrallë

## Vdes e vetmuar dhe në varfëri, më pas zbulohet se kishte qenë milionere

Një grua e moshuar vdiq mes varfërisë dhe vetmisë pa e ditur se në të vërtetë kishte qenë milionere. Rafaella Donvito, jetonte në Milano dhe vdiq vitin që lamë pas. Komunës iu desh ta priste një muaj për ta bërë ceremoninë mortore pasi asnjë familjar apo mik nuk dukej për ta tërhequr arkivolin. E lindur në Tripoli



më 1940 gruaja u thoshte fqinjëve se nuk kishte asnjë të afërm në Itali vetëm disa kushërinj të largët në ShBA. Vetë bënte një jetë të thjeshtë dhe të varfër. Pasi vdiq u zbulua se gruaja kishte ishte trashëgimtare e dy shoqërive imobiliare dhe disa tokave në Lombardi.

## BARSOLETA E DITËS



Endriti: Më fal, a ke shkrepëse, bre?  
Blendi: Po, more!  
Endriti: Mos ke edhe një cigare, bre?  
Blendi: Edhe cigare kam. Po, prit, mos dil, ja merre edhe xhakëtën time se ish ftoftë.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

## "THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

## "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

## "MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

## "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




**DASHI**

Sot parashikohen debate me partnerin. Në shumë gjëra nuk do të ndani të njëjtin mendim.



**DEMI**

I gjithë fokusi juaj sot është përqendruar te financat dhe te karriera. Jeni në zhvillime shumë të rëndësishme për të ardhmen në këto fusha.



**BINJAKËT**

Një ditë e qetë dhe me të gjitha gjërat të mirë organizuara. Do të jeni mjaft të dashur me personat që kenë afër vetes.



**GAFORRJA**

Po e nisni këtë ditë me këmbën e gabuar dhe kjo gjë do të reflektojë në çdo vendim tuajin në orët në vazhdim.



**LUANI**

Sot jeni shenja më me fat e Zodiakut. Çdo gjë është siç dëshironi, madje disa situata do të dalin më mirë seç e prisnit.



**IRGJËRESHA**

Jeni përqendruar në investime afatgjata, por dita e sotme do t'ju kushtëzojë të zgjidhni sa më shpejt disa probleme financash.



**PESHORJA**

Sot jeni ju protagonistët e ditës dhe kjo gjë do t'ju pëlqejë. Në çdo aspekt do të kërkonim më të mirën e gjërave.



**AKREPI**

Duhet të përshtateni me ndryshimet sot. Do të ndodhin shumë shpejt dhe ju do të jeni të luhatur përgjatë gjithë ditës.



**SHIGJETARI**

Sot jeni përqendruar në objektivat më të shpejta për t'i arritur. Persona afër jush duan të përfitojnë në atë që mund të arri.



**BRICJAPI**

Sot nuk po organizoheni dot siç duhet. Fillimi i javës do t'ju gjejë kaotikë dhe në rrëmujë e sipër.



**UJORI**

Do të jeni tip flirtues gjatë gjithë ditës. Keni mbi vete sharmin e personave që dinë çdo gjë dhe njohin këdo.




**PESHQIT**

Në dashuri do t'ju hapen porta të reja që nuk i kishit imagjinuar. Një takim i rastësishëm do të jetë mjaft interesant.



## Ricardo Kaka do të martohet me një tjetër Carolina



Është një periudhë lumturie për Ricardo Kakan, i cili ka njoftuar publikisht se po përgatitet për dasmën. Pritet të jetë ceremonia e dytë martesore për ish-yllin e Milanit, i cili në vitin 2015 është divorcuar nga bashkëshortja e parë, Carolina Celico (pas nëntë vjetësh martesë dhe dy fëmijëve, Luca e Isabella).


Përmes një postimi në profilin e vet në "Instagram", braziliani ka njoftuar se i ka propozuar Carolina Dias, modeluese braziliane 25-vjeçare dhe partneres aktuale. "Më ke bërë njeriun më të lumtur në botë! Të premtoj se do të të bëj gruan më të lumtur në botë! Të dua", ka shkruar ish-fituesi i "Topit të Artë".

## Rossi mohon planet për martesë me bukuroshen italiane



Prij më tepër se një muaji Valentino Rossi ka marrë pushimet, pasi mbylli sezonin e 2018-s dhe është në pritje të marsit, për të filluar një tjetër vit si pilot i Moto GP-së. Edhe këtë herë piloti italian do të garojë mbi motorin Yamaha, por synimi është të rikthehet te titulli

kampion që i mungon prej disa vitesh. Në pritje të sezonit të ri, Vale Rossi po shijon pushimet nën shoqërinë e të fejuarës së tij, Francesca Sofia Novello, me të cilën është folur se do të martohet së shpejti. Por Yamaha ka pohuar se ende nuk kanë vendosur asgjë në lidhje me martesën.



## Dua Lipa në dhjetëshen e albumeve më të shitur

Dua Lipa është artistja femër me albumin më të shitur gjatë vitit 2018. Ajo ishte e vetmja femër në top 10 albumet më të mira të artistëve vitin e kaluar. Albumi 'Dua Lipa' ndodhet në vendin e nëntë në tabelën e Official Charts.

Dua Lipa gjithashtu e kishte këngën e dytë më të transmetueshme të vitit "One Kiss" me Calvin Harris si dhe këngën e nëntë më të transmetuar, "IDGAF". Vendin e parë e mban "The Greatest Showman" e Motion Picture Cast Recording.

## Aktori i famshëm i gatshëm ta dhurojë zemrën për vëllanë binjak



Vëllai binjak i aktorit të famshëm Ashton Kutcher, Michael, ka zbuluar se ylli i Hollywoodit ishte i gatshëm ta dhuronte zemrën për ta ndihmuar në kohën kur ata ishin adoleshentë. Michael, i cili jeton me paralizë cerebrale, është ende gjallë sot për shkak

të transplantimit të zemrës që ai bëri kur ishte vetëm 13-vjeçar, në kohën kur Ashton u ofrua ta dhuronte zemrën për ta shpëtuar binjakun e tij. 40-vjeçari ka thënë se nuk mund t'i gjejë fjalët e duhura për t'i përshkruar ndjenjat e tij për të vëllanë, yllin e Hollywoodit.



Në 50-vjetorin e demonstratave të vitit 1968 (2)

# VITI 1968, VIT I KTHESËS SË MADHE HISTORIKE



Selatin NOVOSELLA

Pas hapjes së diskutimeve për ndryshimet kushtetutare, në vitin 1968 ishin mbajtur shumë tubime në komitetet komunale gjithandej Kosovës, si dhe në nivelet e institucioneve të shkencës, por edhe në nivelet më të ulëta të pushtetit lokal. Fillimisht, në këto tubime ishte kërkuar avancimi i statusit të Krahinës së Kosovës në nivel të Republikës. Po ashtu ishte kërkuar që në nivelet e federatës jugosllave krahina e Kosovës dhe e Vojvodinës të përfaqësoheshin me numër të njëjtë të delegatëve, në nivel të Federatës, si edhe republikat e Jugosllavisë: Serbia, Kroacia, Sllovenia, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi. Çka është edhe më e rëndësishme ishte kërkuar edhe e drejta e vetëvendosjes për Kosovën. Këto diskutime kishin vazhduar deri në verën e vitit 1968. Historiografia e ka për detyrë të studioj dhe hulumtoj në dokumentet e kohës për të konstatuar se përse u ndërpre këto diskutime?!

Pas ndërprerjes së diskutimeve në nivelet partiake dhe shtetërore të Kosovës për dyshimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, në këto diskutime u kyçën personalitetet e njohura të shkencës dhe dijes në Kosovë. Në këto propozime dhe diskutime do të dallohen, posaçërisht: Gazmend Zajmi, Fehmi Agani, Ali Hadri, Syrja Pupovci, Mark Krasniqi, Hajredin Hoxha etj. Duke u thirrur në argumente historike por edhe në proceset dhe ngjarjet politike nga e kaluara, këta intelektualë do të përipiqen ta argumentojnë se Kosova kishte të drejtë të shpallej republikë. Pas një periudhe të shkurtër kohore edhe këta intelektualë do të heshtin, disa prej tyre edhe do t'i mohojnë deklaratimet e tyre të mëparshme për avancimin e statusit të Kosovës në nivel të republikës në përbërje të ish-Jugosllavisë. Ajo që vlen për vlerësimet e historianëve dhe analistëve për ndërprerjet e qëndrimeve të politikanëve shqiptarë, e njëjta vlen edhe për vlerësimet dhe për qëndrimet e intelektualëve pse u tërhoqën nga kërkesa dhe pozicioni i drejtë historikisht për avancimin e pozitës kushtetuese të Krahinës së Kosovës në nivel të Republikës?!

## 6. Demonstratat e vitit 1968 në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi

Siç u theksua edhe më parë, Lëvizja Çlirimtare Kombëtare në Kosovë dhe viset tjera shqiptare në ish-Jugosllavi asnjëherë nuk kishte pushuar së përpjekuri që të realizohej kërkesa bosht e shqiptarëve - ribashkimi me shtetin amë Shqipërinë. Megjithatë, viti 1968 në Kosovë do të sjellë një frymë të re dhe një qëndrim pak më ndryshe

që bënte përjashtim nga programet politike të Lëvizjes Kombëtare të deriatëherëshme, e kjo ishte qëndrimi që të kërkohej Republika e Kosovës në kuadër të ish-Jugosllavisë, gjithsesi, si hap fillestar për realizimin e formimit të Republikës së pavarur të Kosovës. Në vitin 1968 në Prishtinë vepronte një formacion i organizatës atdhetare Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, e cila ishte themeluar nga Adem Demaçi në vitin 1963. Ky formacion ishte i përbërë, kryesisht, nga anëtarët e Grupit të të Rinjve të LRBSH-së, të cilit në vitin 1964 kishin vepruar në të organizatë, për çka ishin dënuar me dënime jo të gjata dhe ishin përjashtuar nga shkollat e mesme ku po shkolloheshin. Tashmë, në verën e vitit 1968, ky grup do të riorganizohet dhe të shtrojë mundësinë të avancojë në veprimtarinë atdhetare - politike. Bërthamën e këtij formacioni e përbënin: Osman Dumoshi, Ibrahim Gashi, Adil Pireva, Shemi Hoxha, Ilaz Pireva dhe Selatin Novosella. Pas dilemave dhe shqetësimeve që ishin krijuar në opinionin politik të Kosovës, pas tërheqjes së politikanëve dhe intelektualëve, nga kërkesat për statusin e Republikës së Kosovës, pikërisht në këto rrethana politike do të merret vendimi, definitiv, që të organizoheshin demonstratat në Prishtinë dhe në sa më shumë qytete të Kosovës. Kjo ide do të merret mbështetje dhe shtytje nga intelektualit i shquar Ismail Dumoshi, i cili ishte në relacione të afërta me disa udhëheqës politikë dhe intelektual të kohës. Pas konstatimit të Ismail Dumoshit se janë ndërprerë të gjitha mundësitë që të realizohej avancimi nivelit politik të Kosovës në vi institucionale, merret vendimi, përfundimtar, që ky avancim i statusit politik të Kosovës të kërkohej me mjete të presionit politik, nëpërmes demonstratave masive.

Demonstratat e zhvilluara gjithandej në botë, me theks të veçantë në shtetet e Evropës Perëndimore dhe në disa qytete të ish-Jugosllavisë si dhe demonstratat e zhvilluara në tri qytetet e Rrafshit të Dukagjinit, në Prizren më 6 tetor, në Therandë më 9 tetor dhe në Pejë më 19 tetor, ishin trimërim, kurajim dhe shtytje e fuqishme që në Prishtinë të ngritej niveli i organizimit dhe të mos pritej më tutje. Për këtë qëllim do të mbahen disa mbledhje, në fshtësi të thellë, të Grupit të të Rinjve të LRBSH-së, që, tashmë, ishte zgjeruar me anëtarë të rinj. Në këto takime, që do të mbahen në shtëpi të ndryshme duke i ikur syrit zhbirues të UDB-së, do të mirren këto vendime:

1. Caktohen anëtarët e Grupit për konsultime me veteranët e Lëvizjes Çlirimtare Kombëtare: Osman Dumoshi me Kadri Halimin, Hasan Dërmaku me Metush Krasniqin dhe Selatin Novosella me Hyrije Hanën;
2. Caktohen anëtarët e Grupit për koordinimin e veprimeve organizative me qytetet tjera të Kosovës: më Podujevën - Xheladin Rekalii, me Ferizajn - Skënder Kastrati dhe me Gjilanin - Asllan Kastrati;
3. Caktohet data e mbajtjes së

demonstratave në Podujevë, në Gjilan dhe në Ferizaj, më 27 nëntor, në ora 5 minuta në 12, ndërsa në Prishtinë, po më 27 nëntor, por në ora 5 minuta në 16;

4. Caktohen tekstet e 50 pankartave që do të shkruhen dhe do të brohoriten gjatë demonstratave në Prishtinë: Skënder Muçolli, Afrim Loxha dhe Ilaz Pireva;

5. Caktohen autorët që do ta shkruajnë, lekturojnë dhe shtypin fjalimin që do të lexohet para demonstratave në Prishtinë: ta shkruajnë Adil Pireva dhe Osman Dumoshi, ta lekturoj Ismail Dumoshi, ndërsa ta shtypë në makinë shkrimi Selatin Novosella;

6. Caktohen personat që do ta lexonin fjalimin gjatë demonstratave: Osman Dumoshi dhe Hasan Dërmaku;

7. Caktohen personat që do t'i transportonin pankartat dhe flamurit kombëtar, nga vendi ku ishin shkruar transparentat, deri tek objekti i Fakultetit Filozofik, në Prishtinë, prej nga do të fillonin demonstratat;

8. Caktohet data e mbledhjes së ardhshme, pas përfundimit demonstratave, më 30 nëntor.

Të gjitha këto detyra të caktuara do të realizohen me disiplinë, pothuaj, ushtarakë. Propozimet, sugjerimet dhe idetë e dhëna nga Kadri Halimi, Metush Krasniqi dhe Hyrije Hana, nëpërmes personave të caktuar nga Grupi i të Rinjve, do jenë mbështetje e fortë dhe ndihmesë me shumë interes për zhvillimin e demonstratave, sidomos të atyre të në Prishtinë. Kështu, veprimtarja e shquar, Hyrije Hana, ish-partizane, ish e burgosur politike nga pushteti jugosllav në vitin 1961 dhe motra e dëshmorit Xheladin Hana, në takimin e fundit, vetëm pesë ditë para demonstratave, i jep këto propozime organizatorëve nëpërmes Selatin Novosellës:

1. Të mos shkruhen parullat:  
- "Duam Republikën e Kosovës!"  
- "Poshtë Fadil Hoxha!"  
- "Rroftë Enver Hoxha!"  
- "Poshtë Josip Broz Tito!"

2. Shkruhen parullat:  
- "Duam vetëvendosje deri në shkëputje!"  
- "Lufta Nacionalçlirimtare nuk na ke sjellë barazi!"  
- "Kërkojmë bashkimin e viseve tjera shqiptare në Jugosllavi me Kosovën!"  
- "Poshtë Veli Deva!"  
- "Poshtë Misha Sekulloviqi!"

Ndërsa organizatorët e demonstratave do të vendosin që të shkruhen edhe këto parulla:  
- "Kërkojmë përdorimin e lirë të

flamurit kombëtar!"

- "Kërkojmë Universitetin e Prishtinës!"

- "Kërkojmë kushte më të mira për studentët!"

- "Më mirë vdekje se robëri!"

- "Në njërën dorë kazmën - në tjetrën pushkën!"

- "Rroftë klasa punëtore!"

- "Rroftë fshatarësia!"

- "Liri për të burgosurit politikë!"

- "Rroftë Adem Demaçi!"

Etj.

Demonstratat në Podujevë, në Gjilan, në Ferizaj dhe në Mitrovicë, do të zhvillohen, sipas planifikimit, bashkorganizimit dhe koordinimit në mes organizatorëve të këtyre qyteteve dhe qendrës në Prishtinë, në orët e paradites së 27 nëntor 1968, ndërkohë që një numër i madh i demonstruesve nga këto qytete ku ishin zhvilluar demonstratat por edhe nga qytetet tjera të Kosovës do t'i bashkëngjiten demonstratës kryesore në Prishtinë, në ora 5 minuta në 16. Prej fillimit të demonstratës në Prishtinë, në kohën e caktuar, 5 minuta në 16, e deri në përfundimin e tyre rreth orës 22, do të jetë një manifestim kombëtar - politik, masovik, i dinjitetshëm, i guximshëm, i vendosur dhe gjithëpopullor. Nga të gjitha parullat e përgatitura paraprakisht nga organizatorët, qofshin ato të shkruara në pankarta, qofshin ato në fjalimin e përgatitur enkas, më së tepërmi do të brohoriten parullat:

- "Duam Republikën e Kosovës!"

- "Duam vetëvendosje!"

- "Duam Kushtetutën e Kosovës!"

Përkundër planifikimit dhe dëshirës së organizatorëve të demonstratave që të mos vinte deri te konfrontimi me organet e rendit, policinë, megjithatë kjo do ndodhë pas sulmit të policisë me armë zjarri, me gaz lotsjellës dhe me topa uji. Gjatë këtyre demonstratave do të vritet i riu 17-vjeçar, nxënësi Murat Mehmeti, do të plagosen mbi 20 demonstrues me armë zjarri dhe do të lëndohen qindra të tjerë gjatë kacafytjeve dhe përleshjeve të demonstruesve me policinë.

Pas përfundimit me sukses të plotë të demonstratave në tri qytetet e Rrafshit të Dukagjinit, në Prizren, në Therandë dhe Pejë dhe në qytetet Rrafshit të Kosovës - në Prishtinë, në Podujevë, në Ferizaj, në Gjilan dhe në Mitrovicë, do të ndërmerren masa ndëshkuese represive të organeve të sigurimit shtetëror, UDB-së, të Gjykatave për Kundërvajtje, Gjykatave Komunale dhe atyre të Qarkut gjithandej Kosovës. Pas demon-

stratave do të dënohen me qindra demonstrues me dënime të shkurtra nga gjykatat për kundërvajtje, ndërsa nga gjykatat komunale dhe të qarkut do të gjykojnë rreth 30 organizatorë të demonstratave me dënime deri në 5 vite burg të rëndë, gjë që nuk kishte ndodhur në asnjë shtet tjetër në botë dhe as në qytetet e Jugosllavisë, në Beograd dhe Zagreb, ku kishte pasur demonstrata.

Edhe pse gjatë demonstratave të vitit 1968 u përgjakën rrugët dhe sheshet e qyteteve të Kosovës, edhe pse u mbushën burgjet me të burgosur politikë shqiptarë, megjithatë, me këto ngjarje të njohura historike, kështu po hapej një kapitull i ri në historinë e gjatë dhe të përgjakshme të Kosovës. Me këto demonstrata po legalizohej kërkesa për republikën e Kosovës. Demonstratat e vitit 1968 do të jenë një hallkë e fuqishme që lidhte ngjarjet e njohura historike, siç ishin Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, 1939-1945, Lëvizjen Çlirimtare Kombëtare, e njohur si Lëvizja Ilegale Kombëtare, 1945-1968, me ngjarjet edhe më të rëndësishme që do t'i pasojnë këto demonstrata, siç ishin demonstratat e vitit 1981, Lëvizja Politike Paqësore, 1990-1997, duke kulmuar me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila, duke u mbështetur gjithanshëm dhe fuqishëm nga Aleanca e NATO-s, nën udhëheqjen e SHBA-ve, i sollën Kosovës lirinë.

Ndonëse me një muaj vonesë demonstratë shumë të fuqishme u zhvillua edhe në Tetovë. Atje u mbajt qyteti në duart e demonstruesve me 22 dhe 23 dhjetor të vitit 1968. Duke u solidarizuar me kërkesat e demonstratave të manifestuara në demonstratat e Kosovës, demonstruesit e Tetovës por edhe të disa qyteteve tjera shqiptare në Maqedoni, kërkuar realizimin e të drejtave kulturore, shoqërore dhe politike të mohuara nga pushteti maqedonas. Pas demonstratave të shqiptarëve në Tetovë dhe vendbanimet tjera, hakmarrja e pushtetit shovinist maqedonas ishte shumë e egër ndaj demonstruesve. Ajo hakmarrje ishte pakrahueshëm më e egër sesa e strukturave udhëheqëse në Kosovë që u ushtrua ndaj demonstruesve.

Rezultate të drejtpërdrejta i këtyre demonstratave, duke pasur parasysh edhe ngjarjet historike e zhvilluara deri atëherë, por edhe kontributit të strukturave udhëheqëse të kohës, ishin:

1. Lejimi i përdorimit të lirë të Flamurit kombëtar.
2. Hapja e Universitetit të Prishtinës.
3. Rifillimi dhe fillimi i punës i institucioneve shkencore në Kosovë.
4. Fillimi i bashkëpunimit intensiv Kosovë-Shqipëri në fushat e arsimit, shkencës dhe kulturës.
5. Aprovimi i Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974.

(Kumtesë e lexuar në konferencën shkencore e mbajtur më 27 nëntor 2018 kushtuar 50-vjetorit të demonstratave të vitit 1968) (Fund)





# Dhuna seksuale nga forcat ushtarake serbe ndaj grave shqiptare gjatë luftës në Kosovë



**Elife LUZHA**

**- Pushtimi i Kosovës dhe represioni serb mbi shqiptarët etnikë**

Shpallja e shtetit të pavarur shqiptar më 1912, në një kohë luftërash të përgjakshme mes popujve në Evropë e Ballkan, ishte ngjarja më e shënuar në historinë mbi dymijëvjeçare të rrugëtimit të shqiptarëve. Shqipëria u shpall shtet, por gjysma e territorit të saj, si Kosova dhe pjesët e tjera më vitale të kombit si në vlera gjeografike, ashtu edhe në vlera historike, iu aneksuan dhunshëm Serbisë e Malit të Zi, ndër-sa Çamëria iu dha Greqisë. Më 13 qershor 1878, Fuqitë e Mëdha i copëtuan tokat shqiptare në favor të sllavëve, përkundër siç thotë Kissinger (Henry Kissinger): "As Bizmarku (OttoVon Bizmarck), as Dizraeli (Benjamin Disraeli) nuk i donin sllavët e Ballkanit, të cilët i konsideronin ngatërrues kronikë dhe të egër" (Kissinger, 1999:155). Me gjithë përfitimet sllave, në Koncertin Evropian, Rusia ankohej se nuk i kishte arritur të gjitha synimet. Pansllavët, koalicionin evropian e quanin "një dash kurban për dështimin e tyre". E, në fakt, politika e jashtme ruse, thotë Kissingeri, vuante nga propaganda e sëmurë, tema kryesore e së cilës ishte thirrja për një politikë agresive në Ballkan. Kurse "autorë dhe intelektualë rusë e pansllavë, si prozatori dhe nacionalisti i pasionuar, Fjodor Dostojevski apo oficeri Rotislav Andrejeviç Fadejev, altruzimin rus e interpretonin si një obligim për të çliruar popujt sllavë" (Kissinger, 1999:143). "Por Rusia, në politikën e jashtme, nuk është përkrahur si Amerika me konceptet e saj të lirisë e barazisë, që mund t'i përqa-fonte kushdo. Pansllavizmi rus ishte i frikshëm dhe ekspansionist, që duhej ndalur", thotë Kissingeri (po aty). Shqiptarët besonin se në Konferencën e Paqes do të për-

mirësoheshin padrejtësitë e bëra ndaj tyre, gjë që nuk ndodhi. Përkundrazi, më 1913, gjashtë Fuqitë e Mëdha e legalizuan ndërkombëtarisht copëtimin e Shqipërisë.

Sipas Kissingerit, në Konferencën e Londrës, Britania e Madhe e pengoi aneksimin e Shqipërisë nga Serbia, sepse ishte e papranueshme për Austrinë (Kissinger, 1999:199).

Megjithatë, më 1912, serbët e rikthyen kontrollin mbi Kosovën, kurse sipas raportit të Carnegie Endowment\*, të vitit 1914, serbët gjatë kësaj kohe shkatërruan fshatra të tëra, duke vrarë 25 000 shqiptarë etnikë (Sullivan, 2009: 45). "Kështu, një territor i vogël si Kosova, për shkak të konkurrencës së Fuqive të Mëdha, ndër vite shërbeu si një fushë-betejë në vijën e parë të frontit, dhe si një vend nga i cili nxirreshin burime ose kërkoheshin shpagim. Për këtë shembull është miniera e plumbit në Trepçë, e cila u shfrytëzua nga serbët, dhe po nga ata u përdor më 1999, për të djegur kufomat e viktimave të vrasjeve e përdhunimeve masive nga forcat ushtarake serbe" (Dervishi & Shatku, 2001, 31). "Më 1992, agresioni serbo-sllav e ktheu rajonin, e sidomos Bosnjën dhe Kosovën, "në një kazan që ziente, ku serbët prinin në larje të hesapeve të vjetra, në një mënyrë të egër" (Kissinger, 1999:195).

Gjithsesi, kjo egërsi serbe burimin e kishte te lëvizja politiko-kulturore serbe zenitizmi, që kishte lindur mes dy Luftërave Botërore dhe gjatë shek. XIX përhapte ide të kontaminuara kundër Evropës. Kjo lëvizje pretendonte se ka ardhur koha që në skenë historike të dal barbaro-gjeniu, pra njeriu i natyrës, i egër e fisnik, që duhet ta rigjeneroj qytetërimin e kalbur perëndimor. Ky gjeni barbar ishte serbi.

Janë pikërisht këto ide, që çuan në krimet barbare serbe gjatë luftës në Kosovë", shpjegon Arbër Xhaferi, në librin Kombi, identiteti dhe shteti (Xhaferi, 2005: 322, 323).

Shqiptarët e pushtuar në tokat e tyre ishin të detyruar që, krahas luftës për mbijetesë, të organizoheshin në luftën për çlirim, deri në realizimin e aspiratës kombëtare sipas parimit për të drejtën e popujve për vetëvendosje, sepse "fjala ishte për një

popull që jeton në një territor të përcaktuar qartë, nga pikëpamja gjeografike; popull kompakt, homogjen e autokton në trojet e veta" (Nasi, 1994:17). "Ky fakt ishte jo vetëm bindës, por edhe i arsyeshëm për çdo pretendim të shqiptarëve për t'u bashkuar me Shqipërinë, e sidomos tanimë që e drejta ndërkombëtare e kishte legjitimuar parimin e Versajës, për vetëvendosje dhe dekolonizim" (po aty).

Megjithatë, edhe për shumë vite në vijim Kosova nuk u bë e lirë. Terrori dhe dhuna ndaj shqiptarëve vazhdoi deri më 1998-'99, kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK-ja), bashkë me NATO-n e çliruan Kosovën.

## Krimi i dhunës seksuale ndaj grave shqiptare nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë

Përgjatë më se njëqind vjet të pushtimit serb në Kosovë, shqiptarët përjetuan dhunë të egër e të paparë në historinë më të re të kontinentit tonë. Doktrina serbe për asimilimin e shqiptarëve është e hershme dhe "që nga viti 1844 e deri më 1999 serbo-sllavët kanë projektuar dhe zbatuar 24 projekte për shfarosjen e shqiptarëve" (Mehmetaj, 2009:15). Me një fjalë, që nga "Milosh Obrenoviçi e deri te plani Patkoi më 1999, të gjitha planet serbe mbështeteshin nga qarqet më të larta shtetërore dhe kishin një synim të vetëm: shkatërrimin fizik të shqiptarëve në Kosovës. "Sulmet sistematike kundër popullsisë civile, vrasja e mbi 13 000 shqiptarëve, dhunimi i 20 000 grave shqiptare, vrasja e 1392 fëmijëve, vrasja e 1739 grave, vrasja e 10 000 civilëve të tjerë shqiptarë dhe zhdukja e 1653 kufomave civile" (Mahmuti, 2015:293). Kishin si synim realizimin e këtij plani.

Është e vërtetë ajo që besonte Gandhi (Mahatma Gandhi), se "vrasja nuk vret vetëm të vrarët, por edhe vrasësit". Mirëpo në këtë rast, krimet serbe në Kosovë ishin më shumë se aq. Serbët duke aplikuar përdhunimin e grave shqiptare si mjet luftime, donin të vrisnin edhe moralin shqiptar. "Ky ishte kulmi i mizorisë njerëzore, një mënyrë i njohur edhe më parë, por asnjëherë qëllimi kryesor i përdhunimit nuk u kthye si ndihmës kryesor i një doktrine:

thyerjes morale të një populli. Jo vetëm i grave, siç mund të merret në vështrim të parë, por, në radhë të parë, i burrave. Jo vetëm për brezin që po pësonte goditjen, por po aq edhe për brezin e ardhshëm", thotë shkrintari ynë, Ismail Kadare (Kadare, 2011:15).

Sipas Protokollit Ndërkombëtar për Dokumentimin dhe Hetimin e Dhunës Seksuale në Konflikt, "dhuna seksuale është formë e urreyer e dhunës, që përfshin përdhunimin dhe sulme të tjera të natyrës seksuale, të kryer kundër grave dhe vajzave, burrave dhe djemve, që mund të ketë pasoja brutale, ku përfshihen pasojat fizike dhe psikologjike për të mbijetuarit dhe dëshmitarët, por mund të ketë ndikim të thellë destabilizues në komunitetet dhe popullatat në tërësi" (assets.publishing.service.gov.uk/).

Dhuna seksuale mund të ketë pasoja fizike dhe psikologjike afatgjata. Në disa raste viktimat e dhunës seksuale, si dhe dëshmitarët, nën ndikimin e ngarkesës emocionale humbin arsyen e gjykimit, që mund të çojë në humbjen e dëshirës për jetë. Trajtimi i viktimave të dhunës seksuale nga institucionet relevante në këtë rast është jetik! Ndërsa të kuptosh drejt pasojat e dhunës seksuale është burimi për ofrimin e ndihmës adekuate për të mbijetuarit. Por për këtë do të diskutim më në kapitujt në vijim. Tani po u lëmë hapësirë të flasin viktimat e dhunës seksuale, sepse siç thotë Roberto Saviano\*, "nuk mund të ketë rrëfim të vërtetë të një lufte, pa rrëfimin e grave që e kanë përjetuar atë". Mimoza ishte 24 vjeçe dhe kujdesej për prindërit e saj. Ajo ishte personi më i dashur në familje, por një ditë jeta e saj mori një kthesë tjetër "Unë kam qenë fëmija i vetëm në familje. Nuk kam as motër, as vëlla. Për

prindërit e mi kam qenë gjithçka. Në vitin 1999në shtëpi hynë tre policë serbë dhe filluan të rrihnin prindërit e mi. Më pas u kthyen nga unë dhe njëri prej tre policëve më dhunoi para syve të prindërve. Prindërit e përjetuan shumë keq. Më pas më kanë tërhequr zvarrë dhe më kanë lënë në rrugë. Më kanë rrahur shumë. Edhe sot ndiej dhembje në trup. Kam bërë titur sa kam mundur, por askush nuk më erdhi në ndihmë, pasi ishte luftë. Më pas edhe në rrugë më kanë dhunuar dhe më thoshin se do të ma merrnin zemrën dhe do ta peshonin sa kilogram ishte. Kanë pasur një thikë të gjakosur. Pikte gjak të nxehtë"... Pas disa orësh, një fqinj i ka ardhur në ndihmë dhe e ka strehuar në shtëpinë e tij. Në gjendje të rëndë psikike, Mimoza donte t'i jepte fund jetës. Fqinji i ka folur me shumë kujdes dhe e ka qetësuar. Pas kthimit të saj në shtëpi, fillon tragjedia. Rrëfen Mimoza: "Për një kohë kam qëndruar e mbyllur në dhomë. Pas njëfarë kohe të shkurtër, më vdiq babai nga sulmi në zemër. Mërzitej shumë, pasi unë nuk mund të flisja me të. Nuk mundja ta shihja në sy. Më lutej shumë ta pinim një kafe bashkë, pasi e kemi pasur rutinë ditore. Pas ngjarjes, edhe nëna nuk ka qenë më asnjëherë në gjendje të mirë psikike, pasi e ka përjetuar shumë keq dhunimin tim. Një mëngjes nëna ishte afruar pranë bunarit 20 metra dhe ishte hedhur për të vdekur" (<https://drenicapress.info>). "Krimi më pak se çdo gjë, duron dhunimin e të vërtetës. E heshtja për krimin është më i pafalshmi gabim!", thotë Kadareja. Të heshtësh të vërtetat tronditëse të grave si kjo, apo ndryshe si kjo, do të thotë ta lëndosh për vdekje apo ta varrosësh atë me duart e tua. /01.03.2018, Prishtinë. (Vijon)





INTERVISTË

# KRITIKËS LETRARE I BESOJ FARE PAK

Jeni autor i rreth tridhjetë veprave letrare. Sa më kujtohet, veprimtarinë letrare të botimit e keni filluar në vitin 1974, me librin me tregime "Dritat e mesnatës". Pastaj keni botuar romane, tregime, novela, drama, publicistikë. Edhe keni përkthyer vepra të letërsisë botërore. Po të bëja një bibliografi për krijimtarinë tuaj, del se keni botuar: trembëdhjetë romane ("Gjurmë në trotuar", "Portali i perëndive të fyera", "Moti i madh", "Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Net bizantine", "Muri i mjegullës", "Edhe të çmendurit fluturojnë", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E kuqja dhe e zeza", "Prishtina"), pesë libra me tregime dhe novela ("Dritat e mesnatës", "Vdekja pa emër", "Portat e qiellit", "Njëzet tregime për kohën e shkuar", "Hija e qershisë nën dritën e hënës"), dy libra me disa drama ("Tri drama", "Drama"), një libër me kritika ("Shoqërimi", një libër me kujtime ("Mirupafshim në një luftë tjetër"), tre libra publicistikë ("Vite të humbura", "E shtuna ime", "Identiteti kosovar"). Kritika shqipe i ka pritur mirë këto vepra, kurse lexuesit kam parë se kanë përmendur t'u kenë lënë shije më të mirë romani "Edhe të çmendurit fluturojnë", "Im atë donte Adolfin", "E kuqja dhe e zeza". Cilin e pëlqeni ju më shumë prej këtyre që keni botuar?

Po, kjo është bibliografia ime, të cilën e keni gjetur të shkruar diku, por e keni bartur këtu me disa pasaktësi: nuk kam përkthyer shumë vepra të letërsisë botërore (vetëm një, "Mjeshtri dhe Margarita" të Mikhail Bulgakovit); janë katër libra me tregime, jo pesë (i pesti është përzgjedhje) dhe nuk kam shkruar asnjë libër me kujtime ("Mirupafshim në një luftë tjetër" është libër publicistik). Po ta hartonit zërin për mua në Fjalorin Enciklopedik të Kosovës do të dilte se nuk i keni shënimet e sakta dhe se për këtë do të meritoni një kritikë të ashpër publike të stilit "Fjalor i gabimeve enciklopedike" të RTK-së! Megjithatë, sikundër mund të shihet, esencën e kësaj pyetjeje nuk e përbëjnë gabimet, por diçka më substanciale: një autor i gjendur midis veprave të veta, për të cilat duhet të shprehët, duke u përpjekur të formësojë një mendim jo aq subjektiv. A është e mundur kjo? Unë mendoj se jo, sepse letërsia nuk është shkencë ekzakte, është art dhe arti është subjektiv në të gjithë përbërësit e tij. Me anë tjetër, pamundësia për të zgjedhur lidhet edhe me një aspekt tjetër të procesit krijues: po të përcaktohej për një vepër, askush nga



MEHMET KRAJA

autorët nuk do të shkruante një vepër tjetër. Pra, shkrimtari gjithnjë kërkon ta shkruajë kryeveprën e vet dhe veprën e radhës ai synon ta bëjë më të mirën, më të përsosurën. Prandaj, për mua, besoj edhe për shumë shkrimtarë të tjerë, vepra e fundit duhet të jetë më e mira, ajo që pëlqehet më shumë nga autori. Për mua më i pëlqyeri i bie të jetë romani "Prishtina", i fundit në ciklin e veprave të mia. Ndërkaq, sa i përket kritikës letrare, meqë nuk i besoj, ose i besoj fare pak, mendoj se duhet të shprehem pak më qartë për këtë çështje. Në kritikën tonë letrare, dhe në studimet tona për letërsinë, që një kohë ka ndodhur shkarje, e cila duket se është e pariparueshme: që dyzet vjet e këndej kjo kritikë letrare dhe këto studime merren me veten e tyre, më shumë me metodën sesa me objektin e studimit ose të trajtimit. Pastaj, që dyzet vjet dhe më shumë studimet tona për letërsinë marrin për model të njëjtë autorë: Bartin, Todorovin, Zhenetin dhe ndonjë tjetër po të kësaj proveniencë. E dini cilës letërsi i përgjigjeshin këta studiues? Autorëve të ekzistencializmit dhe më pas të anti-romanit dhe anti-dramës: Sartrit, Kamysë, Beketit, Joneskos, Natali Sarrot, Klod Simonit etj. Importimi i modeleve të shkrimit të kritikës dhe të studimeve letrare te ne, së fundi edhe në Shqipëri, ka marrë përmasat e lëndimit serioz të shkrimit diskutiv për letërsinë. Deri në këtë pikë kanë shkruar marrjet joselektive në këtë fushë, sa edhe periodizimi i letërsisë shqipe, ta zëmë, bëhet sipas modelit të letërsisë kroate, pikë për pikë. Ndërkaq, studimet tona letrare e kanë "privatizuar" letërsinë: doktorantët dhe të gjithë ata që varen nga katedra, ose që duan të arrijnë tituj dhe prestigj në këtë fushë, duhet t'u referohen autorëve të caktuar, ndryshe nuk bëhet. Dikur këtë e bënte një klan, tani e bën një klan

tjetër; më herët R. Qosja me mbështetësit e vet, më vonë S. Hamiti, Z. Rrahmani, K. Shala etj. Ky uzurpim i studimeve letrare çoi deri te rreziku serioz që të mbyllen katedrat e albanologjisë, përfshirë edhe Institutin e Albanologjisë për shkak të mungesës së kuadrit ose kuadrit jociësor. Në këto studime mua më përmendin me ndonjë fjali ose paragraf, vetëm pse nuk mund të më anashkalojnë në tërësi, ose ushqejnë iluzionin se vota ime në Akademi mund t'iu bëjë ndonjë favor. Ky përdorim kaq banal i shkrimeve për letërsinë, përveçse ndot ambientin kulturor, krijon situatë dëshpëruese për të gjithë ata që duan të merren me letërsi.

Më lejoni të them këtu se lexuesi nuk është kategori e qëndrueshme kulturore dhe pothuajse asnjëherë nuk funksionon si masë për vlerësim. Aq më parë kur dihet se letërsia e Kosovës, që nga fillimet e saj, ishte letërsi me ndikimin minimal të lexuesit, për të mos thënë se ishte letërsi pa lexues. Kushdo që e lexon këtë që them unë tani, do të krijojë idenë se bëhet fjalë për një mungesë të madhe dhe defekt të rëndë, me të cilin qenka përballur letërsia e Kosovës. Çuditërisht, një situatë e këtillë i ka pasur dhe i ka favoret e veta, sepse bëhet fjalë për një ambient kulturor, ku lexuesi është i paktë dhe pa shije letrare. Kur lexuesi ka mungesa të mëdha në formim, është më mirë që mos ta ketë fuqinë e ndikimit, sepse shkatërrohet fare lehtë një produkt letrar. Kështu, në një periudhë pak më të hershme, lexuesi popullor i Kosovës konsumonte letërsinë e Rilindjes dhe të realizmit socialist të Shqipërisë, më pas filloi të ndihej i liruar nga nevoja për të konsumuar letërsi dhe tani ndihet i lirë mos të konsumojë asgjë që ia ushqen shpirtin dhe mendjen. Kjo bëri që letërsia e Kosovës të zhvillohet e pandikuar nga lexuesi, siç janë zhvilluar shumë letërsi në

shekullin XIX, në kushtet e një analfabetizmi masiv. Prandaj, them unë, po të mbështetej te recipienti, nuk do ta kishim kurrë në letërsinë e Kosovës as Azem Shkrelin, as Ali Podrimjen, në pikturë nuk do ta kishim Muslim Mulliqin dhe as në teatër kurrë nuk do të luhej "Erveheja" e Muharrem Qenës. Me një fjalë, lexuesi le ta bëjë punën e vet, unë timen. Tekefundit, pse unë duhet të kërkoj që të më vlerësojë një lexues i supozuar, kur e di se vetë shkrimtarët nuk lexojnë njëri-tjetrin, madje nuk lexojnë as ata që merren profesionalisht me këtë punë. Nëse doni, bëjeni një anketë me shkrimtarë dhe studiues për veprat e botuara në dhjetë vitet e fundit të letërsisë së Kosovës, apo në letërsinë shqipe në përgjithësi dhe do të shihni sa të turpëruar do të dalin.

## Juritë, në shumicën e rasteve, janë pjesë e klaneve

Veprat që përmenda më parë ju kanë sjellë edhe çmime, si: Çmimin vjetor të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës për veprën më të mirë (për romanin "Moti i madh", 1981); Çmimin "Hivzi Sulejmani" të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës për prozën më të mirë (për përmbledhjen e tregimeve "Vdekja pa emër", 1995); Çmimin e shtëpisë botuese "Toena" për prozën më të mirë nga pesëqind titujt e botuar (për romanin "Muri i mjegullës", 1998); Çmimin "Pjetër Bogdani" të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës për veprën më të mirë (për romanin "Muri i mjegullës", 1999); Çmimin "Pjetër Bogdani" të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës për veprën më të mirë (për përmbledhjen "Njëzet tregime për kohën e shkuar", 2001); Çmimin "Azem Shkreli" të Ministrisë së Kulturës së Kosovës për veprën më të mirë (për romanin "Edhe të çmendurit fluturojnë", 2004); Çmimin "Mitrush Kuteli" të Ministrisë së Kulturës të Shqipërisë (për përmbledhjen e tregimeve "Hija e qershisë në dritën e hënës", 2007); Çmimin "Petro Marko" të Ministrisë së Kulturës të Shqipërisë (për romanin më të mirë të vitit, "Selvitë e Tivarit", 2008). Dmth., edhe keni punuar shumë, po edhe jeni vlerësuar për një punë të bërë mirë. Sa ju kanë motivuar këto çmime që të botoni libra të tjerë?

Nuk besoj se kishit nevojë t'i numëronit gjithë këto çmime, vetëm nëse dëshironi t'ua kujtoni të tjerëve që e lexojnë intervistën. Është e vërtetë se kam marrë shumë çmime por, po ashtu, është e vërtetë se, së fundi, jam refuzuar në dy raste, ku kam

qenë i nominuar: për romanin më të mirë dy vjet më parë dhe për vepër jetësore vitin e shkuar. Në të dy rastet kam qenë i propozuar nga Akademia. Dhe kurrë më, me dijeninë time, nuk do të jem kandidat për çfarëdo çmimi që mund të vijë nga kjo ministri. Kjo nuk do të kishte ndonjë rëndësi sikur të mos kishim të bënim me një fenomen kulturor tërësisht të deformuar i cili arrin deri në këtë pikë të pabesueshme: pasi nuk m'u dha çmimi për romanin më të mirë (për romanin "E zeza dhe e kuqja"), takoj njërin nga anëtarët e jurisë, i cili, supozova se, mbase i gjetur ngushtë, nxori arsyetimin se romani im ishte hequr nga konkurrenca sepse ishte botuar nga një botues i Shqipërisë dhe se këtë e kishte bërë vetë ministri i Kulturës, Kujtim Shala. Kjo ishte gjëja më e shëmtuar që kisha dëgjuar ndonjëherë, prandaj u shpreha publikisht se për një veprim kësajsoj, nën trysinë e opinionit kulturor dhe letrar, do të duhej të kishin dhënë dorëheqje anëtarët e jurisë (Musa Ramadani, Nerimane Kamberi, Agron Gashi, Xhevat Sylja dhe një tjetër që nuk e mbaj mend) dhe vetë ministri. Sikundër mund ta merrni me mend, nuk kishte kurrfarë reagimi, asnjëri nuk u mor me këtë çështje, në një kohë që shteti i Kosovës, institucionet e kulturës dhe komuniteti kulturor e kanë gojën plot me integritet kombëtarë e gjeputa të këtitilla. Meqë ra fjala, dy çmimet kryesore, njërin për roman dhe tjetrin për tregim në Shqipëri, i kam marrë pikërisht nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë, megjithëqë isha shkrimtar i Kosovës. Të gjithë këta anëtarë të jurisë i kam takuar herë pas here vetëm se asnjëri prej tyre nuk pat kurajën të më shikonte në sy dhe të thoshte: Nuk ta dhamë çmimin sepse romani yt nuk ishte gjë! Pra, një çmim që u keqpërdor dhe një juri që u përdor për një "agjendë" idiote të një ministri çapraz. Në të vërtetë, unë asnjëherë nuk jam marrë me punë çmimesh dhe jurish, dhe as këtë herë nuk do të merresha sikur të mos bëhej fjalë për një fenomen kulturor të deformuar, i cili është maja e ajsbergut e një banditizmi kulturor që tashmë na ka përfshirë. Nuk kemi pse fajësojmë të tjerët, është vetë komuniteti kulturor i paqëndrueshëm, primitiv, provincial, mediokër, i degraduar, i cili klanet kulturore i ka kthyer tashmë në banda që po shkatërrojnë çdo gjë. Juritë, në shumicën e rasteve, janë pjesë e këtyre bandave.

(Intervista është marrë nga numri i katërt i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia". Vijnë në numrin e ardhshëm të gazetës)



Intervistë me profesorin, publicistin, dramaturgun Haqif Mulliqi (2)

# Nuk e di a do të shkoj më në teatër

**Bisedoi: Musa KURHASKU**

**Epoka e re:** Ai thotë se i kishte bërë përshtypje të veçantë një prej deklaratave tuaja më të bukura që e kishte thënë diku në një tubim, jashtë Kosovës, se nuk ke dëshirë që të flasësh mbi qëndrimet tuaja politike apo edhe ato të të tjerëve ngaqë qëndrimet tuaja janë shumë lehtë dhe qartë të lexueshme në dramë dhe shfaqjet tuaja.

**Mulliqi:** Për të qenë i sinqertë nuk më kujtohet se me ç'rast e kam thënë këtë gjë, por mendoj se kjo gjë është diçka fare normale dhe e zakonshme për secilin artist që është aktiv dhe i cili merret me çështje publike siç është edhe arti. Sido që të jetë, mënyra më e mirë në të cilën mund të shprehem është ajo përmes punës dhe krijimtarisë sime artistike. Unë ka kohë që nuk jam në gjendje që të artikulohem me ndonjë gjuhë të rregullt politike apo teorike që t'i shpalos qëndrimet e mia politike. Në fund të fundit, unë nuk jam mjaftueshëm i kualifikuar për diçka të tillë. Por ajo që është ndonjë lloj i përcaktimit politik e që për mua është real dhe mënyrë në të cilën unë, sigurisht, besoj se kam aftësi që ta artikulojë është ajo që e bëj përmes dramës dhe teatrit. Sidomos përmes komedisë që e shkruaj një lloj sikurse edhe dramën. Kjo është diçka që është vërtetë e vërejtshme, sidomos në artet më përfaqësuese, në film dhe teatër. Dhe, në këtë kuptim kjo mbase edhe mund të quhet dhe konsiderohet veprimtari politik, por jo edhe ndonjë akt imi individual. Që ta punoj një shfaqje, pra që ta inskenoj ndonjë dramë timen, më duhet që ndonjë grup të madh njerëzish ta bind, në një mënyrë, që t'i honepsin dhe "përfaqësojnë" mendimet e mia politike. Këtë e kam ndjerë, ta themi, sidomos kur e kam punuar dramën time "Një varr për majorin e Mbretit", e cila, për shkak të temës, mund të konsiderohet edhe një manifest politik mbi fitoret dhe humbjet e shqiptarëve gjat Luftës së Dytë Botërore, e sidomos pas tyre. E kjo, atëherë, duhet të jetë ndonjë veprimtari politik. Fundja, teatri vërtet nuk ka kuptim nëse në të nuk i inkuadrojmë njerëzit që e shikojnë dhe nëse ajo që shohin nuk flet asgjë për ta, nëse nuk ua zgjon ndonjë refleksion të brendshëm, atëherë kjo do të thotë se ia kemi huqur në punë. Pra, shikuesit duhen instruktuar që të jenë aktivë në komunikim me veprën tuaj duke i cytur të zhvillojnë mendime aktive në pjesëmarrje në tetarin tuaj. Kjo është e mundshme nëse i "ngacmojmë" duke u sjellë nën rrezatimin e dritave në skenë një ngjarje që u përket, dhe nëse e krijojmë bindjen se ajo, veç të tjerash, flet edhe për jetën e tyre, shoqërinë në të cilën jetojnë si dhe politikën e cila e formëson atë shoqëri. Unë në shumë vende e kam thënë se veprat e mia që më pëlqejnë, mbase më shumë janë ato që nuk e lënë publikun

indiferent. Jo kritikët, ngase të tillë kemi sa për sy e faqe. E këtu ishte shfaqja ime shumë e dashur "Si e mposhta Mussolinin", një vepër të cilën e kam inskenuar para disa vjetësh në Teatrin Kombëtar të Tiranës dhe e cila zgjoi debate të pafundme, për gati gjysmë viti jo për vlerat artistike dhe estetike që kishim sjellë, por për temën e trajtuar. Mbase mend se unë nuk jam përfshirë fare në polemikë, porse ndjenjën e kam pasur shumë pozitive për të gjitha ato që kanë ndodhur rreth shfaqjes. Gjithashtu, në një taban të fuqishëm politik qëndron edhe drama ime "Trenat", në veçanti komeditë e mia "Asgjë të re në jug" dhe "Komedia" në të cilat, në një mënyrë apo tjetër shpërfaqen edhe shumë prej ideve të mia politike të cilat, në një diskutim tjetër shoqëror nuk besoj se do t'i shpalosja ndonjëherë.

**Epoka e re:** A qëndron arsyeja që disa prej dramave dhe shfaqjeve tuaja që janë së tepërmi të drejt-përdrejta mund t'ua kenë konfliktuar me të tjerët?

**Mulliqi:** Unë nuk e kam menduar ndonjëherë këtë gjë. Të paktën jo kështu, në formën qysh po e thoni ju. Është e mundshme të jetë edhe kështu, nuk e përjashtoj mundësinë. Por që mos ta teproj dhe mos ta ngarkoj "shpirtin", paqsa se kam hasur në pengesa të panumërta në punën time krijuese dhe se kam këmbëngulur që të mos më nënshtrojnë asnjëherë, unë asnjëherë nuk e kam ndjerë veten të jem ndonjë lloj disidenti. Bile, vazhdoj të mendoj se kurrë nuk jam ndjerë të kem qenë në konflikt me ndonjë grup të caktuar, madje as me individë në çfarëdolloj kuptimi, për diçka që ndërlidhet me teatrin dhe punën time aty. Të paktën unë mendoj se kjo nuk ka ndodhur. Ndërsa, kurdo të më ketë shkruar mendja se, mbase, po ndodh diçka dhe, ta themi për katër a pesë vjetet e fundit nuk më kanë lejuar të punoj në Teatrin Kombëtar të Kosovës, paqsa se me Ymer Shkrelin duhet të jem autori më i inskenuar shqiptar aty, megjithatë kam menduar se kjo, ndoshta, është e natyrshme apo edhe se mund të ndodhë për shkak të injorancës, të smirës apo edhe egoizmit të individëve të caktuar më shumë sesa mund të jenë çështje të ndonjë përcaktimi tim apo edhe angazhimi artistik dhe profesional.

Unë shkruaj drama dhe në këtë nuk mund të më pengojë askush më. Gjithashtu kam dëshirë të bëj edhe regji të shfaqjeve dhe kjo, bashkë me punën në Fakultetin e Arteve, pra punën me studentët e mi të jashtëzakonshëm, besoj të jetë puna e dytë më e rëndësishme për mua, edhe pse besoj se di të merrem edhe me punë të tjera, madje me po të njëjtin sukses. Gjithashtu, unë vetë nuk kërkoj e as që kam kërkuar që, ndonjëherë, të bëj regji diku kur nuk e kam pasur ndonjë ide premtuese se mund të absolutoj me sukses ndonjë ide artistike. Këtyre ideve u them edhe gjetje të



**HAQIF MULLIQI**

mira. Thjesht, kurrë në jetë nuk më ka ndodhur që të shkoj në ndonjë teatër të punoj ndonjë shfaqje e të mos jem i përgatitur maksimalisht. Asnjëherë. Mendoj se nuk do të dija ta punoj ndonjë shfaqje cilësore mbrapa së cilës nuk do të qëndroja dhe e cila nuk më intereson si problem, por politikën repertoreshke të teatrove tona janë, për fat të keq, shumë shpesh të atilla që të mos jenë të definuara dhe njerëzit nuk e kanë idenë se çfarë nevojitet e çfarë nuk do të nevojitet të kishte aty.

**Epoka e re:** A është kjo arsyeja se në Teatrin Kombëtar të Kosovës nuk keni shkelur plot katër vjet?

**Mulliqi:** Jo, jo, jo... Unë jam rritur me atë teatër. Për më shumë se 45 vjet kam shkruar aty. Madje më nuk më kujtohet as cila ka qenë shfaqja e parë të cilën e kam shikuar në atë skenë. Por, pikërisht para katër vjetësh, kur isha anëtar i Këshillit Drejtues të atij teatri, ku mua dhe ndonjë kolegë timin na kishin lutur që të pranojmë të ishim aty, në një ndërrim qeverie na kanë hequr për arsye të cilat as sot nuk i di. Më kanë thënë disa kolegë se ai, thjesht, ka qenë vendim politik, por nuk do të doja të besoj. Ata që na hoqën mbase kanë dashur të më thonë se më nuk e kam vendin aty. Kur na hoqën, të gjithë kanë heshtur. Mbase edhe u gëzuan. Zoti e di përse. Heshtakët e ziliqarët. Dhe, thënë të drejtën, as në këtë çast kur po bisedojmë më nuk e di se a do të shkoj ndonjëherë në atë teatër.

**Epoka e re:** Profesor Mulliqi, para pak ditësh në botim të Shtëpisë Botuese "Armagedoni" doli nga shtypi edhe vëllimi i dytë i librit tuaj studimor "Teatri, drama dhe identiteti kulturor në Kosovë"?

**Mulliqi:** Po, dhe më duhet ta them se për botimin e këtyre dy vëllimeve të studimit tim të gjatë mbi aspektet antropologjike të dramës dhe të teatrit në Kosovë meritat kryesore i ka botuesi im, Berat Dakaj, i cili me shtëpinë e tij botuese "Armagedoni" jo vetëm se ka bërë ndryshime në fushën e botimit të librit të ne, por edhe ka vënë standard të ri në këtë fushë. Nuk e besoj se pa punë dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të Dakaj ky studim imi do të realizohej për shumë kohë. Për

këtë arsye e falënderoj nga zemra.

**Epoka e re:** Në të dy vëllimet, studimi "Teatri, drama dhe identiteti kulturor në Kosovë" që është një vepër vërtet voluminoze, dhe një përpjekje e veçantë e serioze për t'i bërë një studim dramës shqipe përmes përthyerjes antropologjike, duke krijuar kështu një dialog dhe "grindje" e madhe termash, nocionesh, referencash, veprash, dukurish, problemesh apo, me pak fjalë, një tërësi të pacenueshme të cilën studiuesi Josif Papagjoni e quan lojë tuajën mbi një "pentagram" të vështirë. A mund të na e sqaroni lidhjen ndërmjet dramës dhe teatrit me njeriun bashkëkohor dhe mitin në kohën që po e jetojmë?

**Mulliqi:** Edhe pse nuk ekziston ndonjë definicion i gjithëpranueshëm mbi atë se çfarë është antropologjia, megjithatë shumicën e studiuesve përbashkon edhe mendimi se ajo paraqet një tërësi të disiplinave që merren me studimin e karakteristikave fizike dhe shoqërore të bashkësive njerëzore në procesin e sistematizimit të kodeve historike dhe gjeografike, të rrethanave kulturologjike, të religjionit dhe ritualit si dhe të lidhjeve ndërmjet anëtarëve të një bashkësie të caktuar. Dhe kjo, s'do mend se është një lloj sfide për çdo studiues të dramës dhe të teatrit të cilët besojnë se njeriu është një qenie aktive dhe tejet komplekse, në shumë fusha dhe dimensione, siç është komplekse edhe bota dhe shpirti i njerëzve të cilët shumështrihen në dramaturgjë dhe në skenë. Harvudi këtë e quan një botë komplekse e cila nuk krijohet thjesht dhe vetëm nga mjedisi dhe ndikimi i jashtëm, por ai edhe nga bota e brendshme e personazheve që veprojnë duke shtruar politikim fondamental te mjedisi në të cilin veprojnë njerëzit (në rastin tonë personazhet) dhe ajo që i rrethon ata. Kjo mendoj se është lidhja ndërmjet antropologjisë, dramës dhe teatrit, ndërkohë që antropologjia, si shkencë, e merr mbi vete detyrën komplekse që t'i shqyrtojë të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet njeriut dhe botës së tij, por edhe rezultatet që burojnë nga këto marrëdhënie të cilat na fusin thellë në identitetin e individit dhe grupit të cilit i përket ai.

Edhe nga jeta që e jetojmë vetë ne, sot, sipas të kuptuarit të genies njerëzore, përditshmërisht realizohen trashëgimi të ndryshme shoqërore përmes të cilave njerëzit i kënaqin nevojat e tyre që krijohen dhe që riciklohen në mënyrë të vazhdueshme e të cilat shpërfaqen përmes miteve të ndryshme, shkencës, filozofisë, besimeve, artit etj., të cilat përfaqësojnë një sistem normativ, por që, nga ana tjetër, krijojnë hapësirë të jashtëzakonshme për krijuesit e dramës dhe të teatrit, përmes të cilave që nga zanafilla e tyre hetohet përpjekja eksplicite

që të jepen përgjigje në pyetjet e ndjeshme se: çfarë është njeriu, si vepron e, mbi të gjitha, si ekziston ai? Kështu, edhe studimi im është një përpjekje që të hulumtohet kjo botë e ndjeshme dhe komplekse në mënyrë të veçantë, pikërisht duke shëstuar probleme që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me dramën dhe teatrin dhe që ndërlidhen, pandashëm, me antropologjinë. Në këtë përpjekje, mundësi të mëdha më ka dhënë edhe studimi i mitologjisë dhe pranisë së saj në artin tonë dramatik, por jo vetëm. Këtë e thekson në një mënyrë mjaft të ngjashme edhe strukturalisti i njohur Frederik De Sossur, sipas të cilit, njeriu është, në esencë, një qenie intelektuale. Ndërsa në veprën e tij më të njohur "Antropologjia strukturore" Klod Levi-Strosi kulturën e sheh si sistem të komunikimit simbolik nëpërmjet së cilës duhet qasur disa metodave që janë të zakonshme te qasja që u bëhet veprave të caktuara tek teoria e dramës përmes të cilave studiohen karakteristikat morfologjike të një veprë fiksonale dramatike, të një fjalimi politik apo edhe të filmit, për shembull. Sidomos në dramë dhe në teatër efikasiteti i simboleve mund të vështrohet brenda veçorive të tyre indikative përmes të cilave, siç e precizon Levi-Strosi "... strukturat homologe të ndërtuara nga materiale të ndryshme, në nivelet e ndryshme ndërlidhen me njëra-tjetrën".

**Epoka e re:** Lidhur me mitin si dhe letërsinë rrëfimtare, teoricien i shquar i letërsisë Nortrop Fraj pak a shumë e thotë se kur kritiku i qaset ndonjë veprë të caktuar letrare për të më e natyrshme është që fillimisht ta "akullojë", ta injorojë lëvizjen e tij në kohë dhe ta vështrojë si ndonjë ekzemplar të përfunduar të fjalëve.

**Mulliqi:** Në studimin tim të cilit i kam kushtuar më shumë se pesë vjet të jetës sime, kam arritur te disa përfundime të rëndësishme, ndër to edhe ajo se ekziston diçka që do të mund të quhet "bindje në vazhdimësi", e që është diçka që na cytë, për të mos thënë që na mbërthen që t'i shpalosim, një nga një, faqet e një dramë si dhe të vazhdojmë të mbetemi në teatër gjatë një projekioni. Me këtë rast vazhdimësia mund të jetë e logjikshme apo edhe e kuazilogjikshme; të jetë psikologjike apo edhe retorike; mund të gjendet te librat e shenjtitë apo edhe te vargu epik, apo edhe në ndonjë formë tërheqëse siç mund të jetë, ta zëmë, identiteti i vrasësit te drama "Sfinga e gjallë" e Rexhep Qosjës apo edhe hybrisit te "Një Antigonë e re" e Milazim Krasniqit, fenomene këto me të cilat jam marrë në studimin tim bashkë me shumë drama të tjera të autorëve të njohur shqiptarë të dramës.

(Përfundon në numrin e ardhshëm të gazetës)



INTERVISTË ME XHEVDET BAJRAJN

# SHKRUAJ QË TË MUND TA DUROJ JETËN, TË TJERËT DHE VETEN

## Profesor, përse shkruani?

Që të mund ta duroj jetën, të tjerët dhe veten.

## Kush ju frymëzon të shkruani?

Dikur ishte frika nga vdekja, tashti është frika nga jeta, barspeshën gjithmonë e ka mbajtur dashuria.

## Përse shkruani poezi?

Sepse poezia është e vetmja gjuhë që e flet dhe që e kupton Zoti, ai apo ky, që është një, qoftë ai që është në qiell, qoftë ky i Spinozës. Kur njeriu i lutet Atij, ai këtë pa vetëdije e bën me poezi, sepse ashtu i afrohet mbretërisë së pavdekshme të shpirtit.

## I kujtoni poezitë e para që keni lexuar?

I kisha shtatëmbëdhjetë vjet dhe gjendesha buzë humnerës kur në revistën e shkollës i lexova dy poezi të Bodlerit, Albatrosin dhe Himn bukurisë, e bëra një hap drejt tyre apo më morën ato me vete... dhe ja ku më sollën.

## Kur keni filluar të shkruani poezi?

Isha lexues i mirë në fëmijëri, shkruaja poezi për fëmijë, natyrisht, që nga mosha 10 vjeçe, pra, shkruaja, "klithja" si një dhjetëvjeçar.

## Meqë po flasim për poezinë, na flisni pak më shumë për poezinë tuaj. Sa është personale poezia juaj?

Nëse nisemi nga ajo thënia e njohur: Asgjë njerëzore (lexoje lirishit i nderuar lexues edhe shtazore) nuk më është e huaj, poezia ime është shumë personale dhe universale, po ashtu. Me personale sigurohet origjinaliteti, me personale autori shkruan mbi atë që i takon të shkruajë, ndërsa për atë që i takon një individ të caktuar të shkruajë, asnjë shkrimtar a poet, as nga ata që nuk janë më gjallë fizikisht, e as nga ata që janë apo që do të vijnë, nuk do të mund ta tejkalojnë, sepse i takon atij që ta shkruajë atë, sepse është e tij. Pra këtu nuk ndihmojnë pozat. T'i bie shkurt, nëse je limon, portokall, dredhëz, qershij apo domate, kur të shkel këmbë e njeriut, a rrotë kamioni (lexo realiteti), nuk do të ndihmojë asnjë pozë, thjesht, do të prodhosh lëng limoni, portokalli, dredhëze, qershie apo domateje. Kështu që poezia ime përpiket sa më shumë t'i ngajë realitetit që më rrethon, që e ndie, t'i ngaj jetës.

Pra nuk të mbetet gjë tjetër përveçse t'i jepesh i tëri poezisë (artit) duke e ditur se më nuk ka kthim prapa dhe nuk pret asgjë si kundërshtues, përveç orgazmës së shpirtit, festës së shpirtit.

## Kur kam energji të tepruar ligjëroj shumë lëndë

Jeni profesor i poezisë. Çfarë ligjëroni nga ky zhanër?

I ligjëroj disa nivele të poezisë dhe

programet për to i kam bërë vetë. Janë: Poezia I, II, III, IV (nga fusha kreativiteti), Poezia evropiane e shekullit XIX dhe XX, Poezia bashkëkohore latino-amerikane, Poezia bashkëkohore meksikane, Letërsia e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Letërsia e avangardës, edhe këto dy të fundit, natyrisht, nuk e përjashtojnë poezinë. Po ashtu, edhe pse rrallë, e kam dhënë lëndën e Teknikës artistike (kjo është lëndë e ciklit bazik, i kam ndihmuar një apo dy herë akademisë). Dy nga këto lëndë i jap çdo semestër, e kur kam energji të tepruar, i jap edhe tri lëndë, varet nga interesi i studentëve dhe nga disponimi im. Sidoqoftë, dy lëndë i jap çdo semestër.

## Mësimet tuaja të poezisë a po i praktikojnë studentët?

Okey. Ideja ime është që të krijoj poetë. Dhe, deri tash nuk mund të ankohet askush sepse studentët e mi kanë fituar shpërblime kombëtare, bursa shtetërore për letërsi, kanë mbaruar magjistratura dhe doktorata në fushën e poezisë. Pra, nuk jam duke e kryer punën keq!

## Si të mësojmë të shkruajmë poezi?

Është një laborator (shpirtëror) në të cilin përpikem që secilit t'i qëndroj pranë. Nëse kjo do të thotë që ta marr përdore dikë dhe ta fus në botën e poezisë, apo, nëse më duhet ta bëj këtë duke e thyer "gëzhjojën" e ndonjë të talentuari apo të dikujt që tashmë e ka një formësim poetik (sepse ka marrë kurse private nga poetë të njohur, apo ka diploma nga shkolla joformale të poezisë).

## Më konkretisht, na mësoni si të shkruajmë poezi?

Po i bie shkurt, unë e kam mbijetuar luftën (në të vërtetë jeta është një luftë permanente).

E zbulova se:

...sa bukur është të humbasësh punën të mbetesh në shtëpi o të dalësh nga ajo pa e ditur se për ku je nisur dhe çdo të bësh

Zbuluam se të thyhet këmba a dora

do të thotë se je gjallë

se jeta është e bukur

e hidhur dhe e bukur përderisa jetohet në liri\*

(\*Fragment: Dikur dhe tani, Copa ime e qiellit, f. 269, Botimet "Koha", 2015)

Dhe, po ashtu, e zbulova se jeta e njeriut është shumë e shkurtër dhe nëse do dikush të "klithë" si njeri, atëherë është o sot o kurrë, apo: kurrë nuk është vonë për të klithur.

Pra, nisem nga supozimi se të gjithë studentët janë "normalë", thyej gëzhoja, shtyj përpara apo ua jap dorën dhe i tërheq. Nisem nga ajo që shumica e banorëve në Nju Jork, L. A., Majami, Sietl, Tokio, Berlin janë skllavë të rutinës, botës ideale/racionale të



XHEVDET BAJRAJ

prindërve të tyre, të kushërinjve, të lagjes, të shkollës, të religjionit. Pra, nuk është bota që e ka krijuar perëndia për të, është diçka e gjallë, që lëviz nëpër dekada e shekuj, por që nëpër dekada e shekuj individit është not compatible (paramendojeni një gay në botën shqiptare).

## Sa fjalë dhe sa kohë na duhet për të shkruar poezi?

Okay. Jemi të përgjumur, njeriu është produkt i etikës së kohës në të cilën i ka takuar të jetojë pra, nëse sot thotë se bota është e rrumbullakët, nuk do ta djegin në turrën e druve si dikur. Mos të ndërhyj aty që edhe njerëzit tanë më të dashur, gjatë tërë ditës, me punë apo pa punë, i përdorin, të supozojmë 18 fjali, gjatë javës 35, gjatë muajit të shumtën 45, gjatë jetës, nën 100-200-800... 1 500. Dhe shumicën e tyre, ndër të tjera, për ta përshkruar dhimbjen e dhëmballës, dhimbjen për humbjen e një njeriu të dashur (nënës, babait, motrës, vëllait), dashurinë apo mungesën e saj. Fëmijën të cilit prindërit, me tërë dashurinë e mundshme të botës/kohës në të cilën jetojnë, e "vrasin". Pos prindërve, e vret farefisi, lagjia, shkolla, qyteti (prishtinali/katundar vs katundar/prishtinali), kombi, shteti (në rastin tonë: shteti, kombi), religjioni.

E pata lexuar si i ri në Rahovec një psikanalist, mbase komercial, ama që la gjurmë të mëdha në jetën time. Nuk më kujtohet për momentin emri i autorit amerikan i cili merr shembullin e zogut të shqiponjës të cilin e kishte çelur pula. Del nga gëzhoja dhe i sheh zogjtë e tjerë të pulës, "familjen e vet". Që nga dita e parë, zogu i shqiponjës i imiton zogjtë e pulës, e më vonë vetë pulat... Një ditë, e ngre kokën dhe e sheh një shqiponjë në qiell. Ky është momenti vendimtar! Ish zogu, ose do t'i shtrijë krahët për të fluturuar drejt natyrës së tij, dmth. t'i përgjigjet zërit, ftesës së nënës natyrë apo zotit të Spinozës (a këtij tjetrit që i lëviz ditën e natën), ose do të "psherëtojë" me xheloz, do të thotë: do ta jepja edhe vetë jetën, vetëm të mund ta shihja një herë botën nga ajo lartësi! Eh, unë u them studentëve që do të ulem

në kulmin e shtëpisë së tyre, në pragun e shtëpisë së tyre, do t'u trokas ditën a natën në dritaren e dhomës së tyre, do të jem (pulëbardha) Jonathan Livingston Seagull i tyre (libri i ?autorit amerikan Richard Bachut, të cilin e pata lexuar në rininë time në Rahovec) dhe që fluturimin do ta bëj art (kundër "natyrës sime"), do të fluturoj sa më poshtë a lart të jetë e mundshme, të qëndroj sa më shumë në qiell, të eci bla, bla, bla, interpretim i lirë ky imi, dmth. do të bëj çmos, ta zgjoj shqiponjën, derrin e egër, buburrecin, merimangën, krimbin, engjëllin, njeriun..., çfarëdo që janë, dhe të klithin atë për të cilën i ka krijuar natyra/perëndia, e jo prindërit, rrethi, shkolla, apo kur të rriten e të martohen, gruaja apo vjehrra.

## Në orët në vijim meksikanëve ua lexoj poezinë Katër këshilla vetes

### Si e nisni një ligjëratë për poezinë?

Kjo është ora e parë e Poezisë I. Pastaj u lexoj poezitë: Çka është poezia të poetit spanjoll Gustavo Adolfo Becquer, Nëse të Rudyard Kiplingut, Arti i poezisë të Borhesit, Arti i poezisë të Vicente Uidobros (Vicente Huidobro), Këngën për fundin e botës të Çesllav Milloshit, Itaka të Kavafisit..., në orët në vijim ua lexoj poezinë e Azem Shkrelit: Katër këshilla vetes.

### Po pastaj...?

Flas, flas, flas, pastaj fillon ora praktike, sepse orët e mia i ngajnjë një laborator poetik. Kështu i mësoj dhe i lodhi me këtë, ta respektojnë traditën e poezisë meksikane (prehispanike dhe posthispanike), ta respektojnë propozimin estetik aktual: meksikan, të shkruar në gjuhën spanjolle dhe atë universale, dhe të përpikem të bëjnë art, se arti fillon pas shkëputjes apo pasi ta fusim në thes dhe e bartim në krahë këtë trashëgimi, por e bëjmë një hap më tutje, në të panjohurën, atje ku na bartin shqisat. Dmth., të ecim në një territor të ri, të pashkelur, të lirë, dhe të jemi të vetëdijshëm për këtë liri, ta respektojmë lirinë që e pushtuam

(për nga natyra është e pamundur të abuzojmë me të), këtë liri që do ta bartë për një kohë emrin tonë, qoftë domethënia e tij "dështim", qoftë një shteg nëpër të cilin do të kalojnë disa poetë të rinj, pasi ta kenë kaluar rrugën tonë, rrugën e secilit që e ka lënë një gjurmë të këmbës, të dorës a të zemrës në këtë botë të shkërdhyer.

### Po pastaj?

Harrova të them se në orët e para u flas për metaforën (jo ashtu si thonë fjalorët retorikë e që te ne i quajnë edhe Teori e letërsisë (fjalorët), pastaj për imazhin poetik (në shumë fjalorë as që ekziston ky nocion), e pastaj i vë përballë metaforën (mbretëreshën e figurave stilistike) dhe imazhin, dhe natyrisht, për shumë arsye, në shekullin XXI fiton imazhi.

## Studentët e mi e njohin mirë poezinë time

### Vetëm u flisni për poezinë, apo dhe i nxisni të shkruajnë?

Pjesa praktike e orës varet nga poezitë që i kanë sjellë studentët. Në të vërtetë, në vazhdim, pothuaj gjithmonë varet nga poezitë që i sjellin studentët. Po ashtu, ju them, eja të ecim bashkë, duke e respektuar unë lirinë tuaj. Edhe nëse humbasim gjatë udhëtimit, unë gjithmonë do të jem i gatshëm t'ju shoh në sy, qoftë kur e merrni ndonjë shpërblim, qoftë nëse takohemi në ndonjë vagon të trenit në metro, ku të dytë do të shesim çamçakëz, apo ndonjë CD me 200-300 këngë.

### Sa e njohin poezinë studentët tu?

T'jua përkujtoj, ata shpesh vijnë në orët letrare ku unë marr pjesë, në konferenca ku flitet për poezinë. Ata e njohin poezinë time dhe, ç'është më e rëndësishme, ata e njohin hapësirën mes dy vargjeve të mia.

### Poezi, poezi, poezi... gjithandej. Çfarë dorëshkrimi keni bërë gati për shtyp?

Jam duke punuar në librin e fundit me të cilën do ta përmbyll trilogjinë, pjesë e projektit të bursës nga Sistemi Kombëtar i Krijuesve Artistikë (të Meksikës), mirënjohje kjo shumë e çmueshme për mua, e pjesë e së cilës janë Lëngu i trëndafilave, botimet "Koha", 2017, Vitet që nuk e sollën pranverën, "Klubi Letrar "De Rada", Ferizaj, 2018. Shkurt, trilogjia ka të bëjë me Kosovën dhe Meksikën dhe libri duhet të jetë gati në qershor të vitit të ardhshëm.

(Intervista është marrë nga numri i katërt i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia". Vijnë në numrin e ardhshëm të gazetës)



# 10 ushqimet që mund të blihen me një dollar në pjesë të ndryshme të botës

Një dollar amerikan është 0.88 euro/cent në vendin tonë dhe, varësisht nga vendi në të cilin ndodhemi, ju mund t'i blini gjërat më të ndryshme me pak ndryshime. Pavarësisht se është një shifër jashtëzakonisht e ulët, në disa pjesë të botës mund të shpenzohet për të blerë dymbëdhjetë vezë, tre hamburgerë me djathë, shishe birra ose vetëm një fetë bukë.

Ja cilat ushqime mund të blihen me vetëm një dollar në pjesë të ndryshme të botës. Gjithashtu, mund të na sugjeroni se çfarë mund të blihet në vendin tonë me këtë shumë parash.

1. Në Holandë është shumë më e lehtë për të gjetur ushqim me një çmim të mirë. Vetëm me një dollar mund të blini dhjetë krepja në supermarket.



1



2



3



5

ekspres më të veçantë, çmimet do të rriteshin nga të paktën 0.30 cent.

8. Në Nigeri, nga ana tjetër, çmimet janë shumë më të ulëta. Me vetëm një dollar ju mund të bëni një aperitiv të respektuar me lëng dhe patate të skuqura.

9. Si në Hungari, madje edhe në Republikën Çeke, pijet alkoolike shiten me çmime të volitshme. Me një dollar mund të blesh më shumë se një birrë, ndërsa uji natyral kushton shumë më tepër.



4

2. Norvegjia është e njohur për një nga vendet më të shtrenjta në Evropë dhe zakonisht shpenzon shumë për një festë në fjordet e saj. Një shembull? Me një dollar ju mund të blini vetëm një kuti të konservuara me makarona të gatshme.

3. Chai është çaji klasik indian i aromave, një delikatesë e vërtetë. Sa mund të blini me një dollar? Gjashtë gota.

4. Malajzia është ndoshta një nga vendet më të lira në botë. Është e lehtë të gresh 10 vezë me një dollar.



7

5. Edhe në Afrikën e Jugut nuk mund të ankoheni për çmimet e ushqimit. Me një dollar ju mund të blini lehtë dy hamburgerë nga Mac Donald.

6. Nëse ju e gjeni veten në rrugët egjiptiane me vetëm një dollar në xhep, nuk ka shumë zgjedhje për

ushqime për të ngrënë. Mund të blini vetëm një kuti konserve me tuna.

7. Me ekuivalentin e një dollar, 0.88 euro, dihet që vetëm një kafe mund të blihet në Itali, dhe këtë në lagje periferike. Më mirë shmangni kapuçinon ose ndonjë

10. Gjërat ndryshojnë në Hong Kong, ku mund të blini vetëm një copë bukë me një dollar. Në rrugët e Hong Kongut, do të ishte më mirë ta përgatitësh ushqimin në shtëpi.



6





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	WOLVERHAMPTON - LIVERPOOL	1	CELTA DE VIGO - ATHLETIC BILBAO	GG	TONDELA - SPORTING LISBON	3+
-------------------	---------------------------	---	---------------------------------	----	---------------------------	----

# Klubet e Superligës dalin në 'gjah'

Shumë klube të Superligës janë përforcuar gjatë fundjavës për sezonin pranveror. Skuadra e fundit në tabelë, KEK-u, ka bërë tri përforcime dhe e ka emëruar Alban Dragushën në postin e trajnerit. Përforcime cilësore kanë siguruar edhe Llapi dhe Flamurtari, kurse Ferizajn e ka kapluar një krizë e jashtëzakonshme

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 JANAR - IPKO Superliga e Kosovës në futboll është në pushim, kurse klubet janë hedhur në aksion për ta shfrytëzuar afatin kalimtar të janarit për përforcimet e nevojshme për pjesën e dytë të kampionatit. Skuadra e fundit në tabelë që ka qenë edhe më e dobëta në sezonin vjeshtor, KEK-u, është duke u përforcuar fuqishëm për pranverë. Kjo skuadër, pasi angazhoi sulmuesit Isa Eminhazirin dhe Enis Zaberxhën, tash ka arritur marrëveshje edhe me ish-kapitenin e saj, Besart Dushin. Risi e madhe nga ky klub është edhe emërimi i Alban Dragushës në krye të shtabit teknik. Trajneri Dragusha e kishte përfunduar karrierën si futbollist në fund të kampionatit të kaluar, kurse në disa ndeshje të sezonit vjeshtor e drejtoi Ramiz Sadiku në Ligën e Parë, ku më pas edhe dha dorëheqje. Shumë aktive në fundjavë është treguar edhe skuadra e Llapit që ka prezantuar dy futbollistë: Flamur Bajramin dhe Elvis Prençin. "Transferimi i parë i afatit kalimtar të janarit te KF Llapi është mesfushori llapjan Flamur Bajrami, i cili është prezantuar me fanellën bardhekaltër. Bajrami ka nënshkruar kontratë dyvjeçare e gjysmë me klubin, ndërsa më parë ka qenë pjesë e 2 Korrikut, Tiranës e Vëllaznimit", thuhet në njoftimin e Llapit. "Qendërmbrojtësi nga Peshkopia, Elvis Prençi, ka arritur marrëveshje me skuadrën e Llapit dhe në këtë edicion do ta veshë fanellën bardhekaltër. Prençi ka luajtur për Kukësin, Partizanin e Tiranës, Teutën, Korabin e Peshkopisë dhe, së fundmi, për Lushnjën. Po ashtu, ai ka qenë pjesë e Kombëtares së Shqipërisë U21", thuhet në njoftimin e skuadrës nga "Zahir Pajzaiti".



Aktive është treguar edhe skuadra e Flamurtarit nga Prishtina. Kuqezinjtë janë përforcuar me mbrojtësin bullgar Angel Grančov, i cili ka luajtur për Lokomotiva Plovdiv, Slavia Sofia, Neftochimic Burgas, Stal Mielec dhe Minyor Pernik. Skuadrën nga "Xhemal Ibishi" e kanë përforcuar edhe Melos Zenunaj dhe Shend Kelmendi. Ndërsa skuadra e Drenicës nëpërmjet një njoftimi për medie ka bërë më dije se sot (e hënë) nga ora 17:00 do të mbahet mbledhja e klubit, në të cilën do të diskutohet raporti njëvjeçar i kryesisë dhe shtabit teknik. "Do të diskutohet dhe vendoset për organizimin dhe synimet për stinorin pranveror. Në këtë mbledhje do të tra-

jtohen edhe tema të tjera në interes të klubit", thuhet në njoftimin e klubit nga Skenderaj. Për momentin punët më se keqi nga skuadrat elitare i ka KF Ferizaj, pasi është duke përjetuar një krizë të jashtëzakonshme. Ky klub nuk ka bërë organizimin, por asnjë ndryshim brenda skuadrës dhe nuk i ka filluar stërvitjet. Çfarë është më e keqja, ende nuk janë kryer obligimet financiare ndaj futbollistëve. Ky klub publikisht ka kërkuar ndihmën e bizneseve nga ky qytet dhe nga kryetari i komunës, Agim Aliu, që të përkrahin financiarisht klubin që të përgatitet për sezonin pranveror, ku synim është mbetja në Superligë.

## SHKURT

### Me sukses operohen dy hendbollistet e Istogut

KH Istogu ka njoftuar se dy hendbollistet e saj, Fatlinda Fezaj dhe Ketevan Venetski, janë operuar me sukses në spitalin "Royal Medical" në Prishtinë nga doktori Qërim Kida. Skuadra që bëri histori në garat ndërkombëtare e ka falënderuar doktorin Kida dhe spitalin "Royal Medical", kurse hendbollistëve iu dëshiroi rehabilitim të suksesshëm dhe rikthim sa më të shpejtë në skuadër.

### Karrica, lojtar i ri i Dinamo Zagrebit

Edhe një tjetër futbollist nga Kosova do të transferohet në futbollin kroat. Bëhet fjalë për futbollistin Bernard Karrica, i cili i ka kaluar provat te skuadra e Dinamo Zagrebit dhe shumë shpejt do të nënshkruajë për këtë klub. KF Gjakova e ka uruar tashmë ish-lojtarin e saj që të ketë suksese në karrierën si futbollist profesionist në një klub të madh siç është Dinamo nga Zagrebi. Për skuadrën e famshme kroate aktualisht luajnë edhe dy shqiptarët Arjan Ademi dhe Amir Rrahmani.

### Fenerbahçe e kërkon Gjimshtin

Fenerbahçe, pas rezultateve jo të mira në Superligën turke të futbollit, po mendon për transferimin e disa futbollistëve në afatin kalimtar të janarit. Në "radarin" e kësaj skuadre është mbrojtësi i Shqipërisë, Berat Gjimshti, i cili aktualisht është pjesë e skuadrës së Atalantas. Nëse klubi turk bën ndonjë ofertë të mirë, atëherë mundësitë janë të mëdha që reprezentuesi shqiptar të transferohet në Turqi.

### Tare e dëshiron Hysajn te Lazio

Elseid Hysaj pritet të ketë një takim të hënën me trajnerin Carlo Ancelotti dhe nga aty do të mësohet mbi të ardhmen e mbrojtësit shkodran. Pas minutave jo të shumtë në fanellën e Napolit në këtë edicion, zërat për largimin e Hysajt po shtohen. "Il Messaggero" raporton se drejtori sportiv i Lazios, Iglu Tare, po tenton ta afrojë Hysajn në skuadrën nga kryeqyteti italian. Pjesë e Lazios janë edhe shqiptarët Thomas Strakosha, Valon Berisha dhe Riza Durmishi.

## Greza: Gerrardi është njeri i thjeshtë

TIRANË, 6 JANAR - Ylli i Kombëtares së Shqipërisë, Eros Greza, e ka vlerësuar trajnerin aktual në skuadrën e Rangersit, Steven Gerrard, si një njeri të thjeshtë. "Gerrardi ishte njeri

shumë i thjeshtë, të lë përshlypje shumë të mira menjëherë. Më ka afruar shumë mirë me grupin, më ka folur shumë mirë, gjithë kohës kam pasur mbështetjen e tij dhe më

ka ndihmuar shumë. Sa herë jam futur në fushën e lojës, gjithmonë më ka thënë bëj atë që di të bësh më mirë. Ne besojmë te ti prandaj je këtu ku je. Është një komunikim shumë i

afërt, është sikur flet me një shok. Nuk e ndiej veten në presion kur flet me të", ka thënë Greza, i cili ndihet me fat që punon me një legjendë siç është Steven Gerrardi.





## Bogdani: Do të doja të luaja ndaj Serbisë

TIRANË, 6 JANAR - Ish-sulmuesi i Shqipërisë, Erjon Bogdani, ka bërë me dije se i ka mbetur merak paraqitja në ndeshjen ndaj Serbisë në Beograd. "Do të doja të kisha luajtur kundër Serbisë. E kam ndjekur nga televizioni dhe ishte shumë emo-

cionuese. Ka qenë ndeshje e bukur. Për mendimin tim, nëse ndeshja do të vazhdohej të luhej, do ta fitonim ne. Unë kam luajtur pak me De Biasin, ndërsa më pas kam qenë pjesë e stafit. Shumë gjëra u mblodhën bashkë për atë sukses.

Trepikëshi që morëm në tavolinë ndaj Serbisë na ndihmoi nga ana morale. Çunat punuan fort edhe në barazimin 0-0 në Danimarkë. Evropiani do të ngelet në zemrën time. E kam të vështirë të flas për kombëtaren tani, pasi e shoh vetëm

nga televizioni ose stadium. Panuccit i është dashur të ndryshojë shumë, pasi kemi një ndërrim brezash. Si lojtarë me të ardhme të madhe do t'i veçoja Asanin e Partizanit dhe Trashin. Janë lojtarë që kanë spikatur", ka thënë Bogdani.



## Curry vendos fitoren e Golden State



CALIFORNIA, 6 JANAR - Kampionët e Golden States fituan 1127-123 ndaj Sacramentos, në fushën e këtij të fundit, ndeshje me rivalitet dhe emocione, ku vendimtar ishte Stephen Curry, autor i 42 pikëve, më i miri në fushë. Mirë u paraqitën edhe Duranti me 29 pikë e Thompsoni me 20, një treshe që bëri diferencën. Për Sacramenton u dalluan Hiieldi me 32 pikë e Jacksoni me 28, por që mbetën për statistikë. Pa problem fitoi skuadra e San Antonios, që mundi 108-88 Memphisin, sfidë e dominuar nga basketbollistët e Spursit, me Whiten që realizoi 19 pikë e Aldridge 18. Vijon sezoni zhgënjyes i nënkampionëve të NBA-së, Clevelandit, që u mund 133-98 nga

New Orleansin, ndeshje ku Holiday e Randle realizuan nga 22 pikë për miqtë. Një fitore të rëndësishme jashtë fushe korri skuadra e Torontos, që mundi 123-116 Milwaukeeen, dy skuadra pretendente për titull në Konferencën e Lindjes. Vendësit patën epërsi në pjesën e parë, ku u dallua Antetokounmpo, autor i 43 pikëve e 18 reboundeve, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Loja e mirë kolektive e skuadrës kanadeze ishte çelësi i fitores për Toronton, ku Leonardo e Siakam realizuan nga 30 pikë, ndërsa Ibaka 25, raporton "Telesport". Denveri ruan kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit, pas fitores 123-110 ndaj Charlotte,

sfidë ku u dallua Jokiçi, autor i 39 pikëve e 12 reboundeve. Fitore të rëndësishme për renditje korri skuadra e Philadelphias, që mposhti 106-100 Dallasin, me Embiid që realizoi 25 pikë e 12 rebounde, ndërsa Utah Jazzi mundi 110-105 Detroitin jashtë fushës falë përmbysjes në minutat e fundit (Mitchell 26 pikë).

REZULTATET	
Denver - Charlotte	123-110
Detroit - Utah Jazz	105-110
Philadelphia - Dallas	106-100
Cleveland - New Orleans	98-133
Milwaukee - Toronto	116-123
San Antonio - Memphis	108-88
Portland - Houston	110-101
Sacramento - Golden State	123-127

## Serena Williamsi: Federeri është tenisti më i madh në histori

Perth, 6 janar - Respekti reciprok nuk mungon në mes të Serena Williamsit dhe Roger Federerit aq sa tenistja amerikane e konsideron zviceranin "tenistin më të madh në histori". Këtë deklaratë Serena Williamsi e bëri pas ndeshjes që dy tenistët luajtën ndaj njëri-tjetrit në Hopman Cup, në lojën dyshe mikse, ku çifti zviceran fitoi ndaj atij amerikan. "Unë mendoj se Rogeri është tenisti më i madh në histori. Unë gjithnjë them atë që mendoj dhe shifrat e konfirmojnë këtë gjë. Është një tenist karizmatik, në fushë e jashtë saj", ka thënë tenistja amerikane që për herë të parë duelonte ndaj Federerit në një ndeshje zyrtare. Më tej, Serena, duke zbuluar një të



fshehtë të Federerit, shtoi: "Njerëzit e nënvlerësojnë shërbimin e Rogerit, por unë them se është e pamundur të kuptosh se ku do të përfundojë topi. Jo më kot është një kampion".

### SHKURT

#### Mourinho refuzon Benfican

Jose Mourinho e ka refuzuar ofertën e skuadrës së Benficas, e cila e shihte portugezin si pasardhës ideal të Rui Vitorias. Mourinho e kishte nisur karrierën te Benfica, por nga e cila skuadër ishte larguar vetëm pas tre muajsh. Strategu portugez që u shkarkua nga detyra e trajnerit të Manchester Unitedit nuk e ka pranuar ofertën e kësaj skuadre, pasi besohet se synimi i tij është marrja e drejtimit të ish-skuadrës së Real Madridit.

#### Interi arrin marrëveshje me Godinin, priten edhe katër transferime të tjera

Me marrëveshjen praktikisht të mbyllur për ta transferuar Diego Godin në Milano, nga muaji qershor, Interi duket se po punon për të afuar disa lojtarë të tjerë me përvojë, por që vijnë me parametra zero. Në listën e Marottës dhe Ausilios kanë përfunduar mesfushori dhe kapiteni i Portos, Herrera, sulmuesi holandez i Bayernit, Arien Robben dhe dy futbollistët e Manchester Unitedit, Antonio Valencia dhe Mateo Darmian.

#### Shevchenko mbron Higuainin

Trajneri i Ukrainës dhe ish-sulmuesi i Milanit, Andriy Shevchenko, e mbron sulmuesin aktual të kuqezinjve, Gonzalo Higuain. Ish-sulmuesi ukrainas ka thënë se Higuain është një sulmues i madh, por që ka qenë i pafat sidomos në ndeshjen ndaj Juventusit. "Ka shumë presion mbi Gonzalon, i cili ka qenë dhe i pafat. I referohem penaltisë së humbur kundër Juventusit, pasi gola të tillë mund të ndryshojnë gjithçka. Ai kishte shumë përgjegjësi në fillim të sezonit, pasi ishte një blerje e madhe. Në ndeshjen kundër Joves të gjithë sytë ishin drejtuar nga ai. Higuaini është një sulmues i madh dhe ai e di mirë që në lojë është dhe e ardhmja e tij. Liga e Kampionëve i siguron qëndrimin në ekip dhe dallohet dëshira e tij e madhe për të qëndruar. Ai dhe Milani duhet të qëndrojnë të qetë në momentet e vështira, pasi çdo moment kalon", ka thënë Shevchenko.

#### Chelsea pas Cavanit

Mosefikasiteti i duhur në fazën e sulmit i ka shtyrë drejtuesit e Chelseat të kërkojnë një sulmues në këtë afat kalimtar. Skuadra angleze raportohet se po bën gati një ofertë prej 56 milionë eurosh për sulmuesin e Paris Saint-Germainit, Edinson Cavani. Sipas "Express", trajneri Maurizio Sarri synon ta marrë uruguianin për t'i zgjidhur problemet në repartin sulmues. Ai po e kërkon lojtarin qysh në afatin kalimtar të janarit. Pas 21 xhirove këtë sezon në Premierë Ligë, Chelsea ka realizuar 38 gola.

#### Van Gaali: Liverpooli, favorit për titull në Angli

Ish-trajneri i Bayern Munchenit dhe Manchester Unitedit, Luis Van Gaal, ka folur për Liverpoolin dhe Manchester Cityn. Trajneri holandez e ka favorizuar skuadrën e Jurgen Kloppit në garën për titull, para skuadrës që drejtohet nga Pep Guardiola. "Liverpooli di të mbrohet më mirë se City. Kloppi e ka transformuar ekipin në një makinë luftarake, si në sulm dhe në mbrojtje, pavarësisht faktit nëse topi zotërohet nga ata, apo jo. Kjo është ajo çfarë i mungon ekipit të Guardiols. Siti ka ide të mrekullueshme për futbollin dhe në fushën e blertë është i shkëlqyer, por nuk ka shpirtin e duhur. Më pëlqen ta shoh Sitin duke luajtur, por Kloppi e bën Liverpoolin të luajë në një mënyrë absolutisht fantastike", ka deklaruar Van Gaali.



# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

